



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 24

2003

Prill

### P Ë R M B A J T J A

|                                      |                                                                                                                                                                                                | Faqe |
|--------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|
| Vendim i GJK<br>nr.9, datë 2.4.2003  | Me objekt shfuqizimin e neneve 41/4; 42/5 e 43/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë .....       | 739  |
| Vendim i GJK<br>nr.10, datë 2.4.2003 | Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1050, datë 26.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr.73, datë 26.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese .....    | 744  |
| Vendim i GJK<br>nr.11, datë 2.4.2003 | Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.99, datë 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.25, datë 4.4.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese ..... | 746  |
| Vendim i GJL<br>nr.1, datë 30.1.2003 | Me objekt njohjen e vendimit penal të Gjykatës së Parë Penale të Apelit të Milanos Itali, nr.6/01 e nr.39/00, datë 2.2.2001, në ngarkim të shtetasit shqiptar Arben Grori....                  | 749  |
| Vendim i GJL<br>nr.2, datë 29.1.2003 | Për të pandehurit Fotaq Zaharia, Elidon Laze, Ridvan Lera, Saimir Osmani.....                                                                                                                  | 759  |
| Vendim i GJL<br>nr.3, datë 30.1.2003 | Me objekt shfuqizimin e dekretit nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës.....                                                                                                      | 767  |

**V E N D I M**  
**Nr.9, datë 2.4.2003**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i “““

Gjergj Sauli, Anëtar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Petrit Plloçi, Anëtar i “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datën 11.9.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.161 Akti që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, përfaqësuar nga zoti Ilir Shurdhi, me autorizim.

2. KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

3. MINISTRI I FINANCAVE, në mungesë.

4. DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE, përfaqësuar nga Silvana Meka, Ibrahim Shatri e Artur Papajani, me autorizim.

5. DEGA E TATIM-TAKSAVE TIRANË, përfaqësuar nga Fredi Meto e Emin Saraçi, me autorizim.

6. SH.P.K. “PEGASO”, përfaqësuar nga administratori i shoqërisë, Piro Anastasi.

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i neneve 41/4; 42/5 e 43/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 42/1 e 134/2 të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 41 pika 4, 42 pika 5 e 43 pika 1 të ligjit të sipërm:

- E drejta e ankimit është një e drejtë që plotëson kuadrin e së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. Kufizimi i saj me ligj bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës e nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore;

- Kufizimi që i bëhet të drejtës së ankimit nuk diktohet nga ndonjë interes publik dhe as nga mbrojtja e të drejtave të të tjerëve;

- Kufizimi i përcaktuar me ligj cenon thelbin e të drejtës themelore të ankimit dhe tejkalon kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi

**V Ë R E N:**

Në kërkesën e paraqitur për shqyrtim, Gjykata e Lartë ka kërkuar shfuqizimin e pikës 4 të nenit 41 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, që ka këtë përmbajtje: “Personi i tatueshëm detyrohet të paguajë TVSh-në, të paraqitur si të pagueshme në vlerësimin tatimor a në vlerësimin e mëtejshëm tatimor, pavarësisht nëse ai ka kërkuar rishqyrtimin apo është ankuar kundër vlerësimit tatimor”. Ajo ka kërkuar gjithashtu shfuqizimin e pikës 5 të nenit 42 të këtij ligji në të cilin thuhet: “Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve nuk fillon rishqyrtimin për vlerësimin tatimor në lidhje me ndonjë person, kur ky person nuk ka bërë të gjitha deklaratimet, të cilat është i detyruar t’i bëjë në bazë të këtij ligji, si dhe nuk ka paguar të gjithë TVSh-në të pagueshme prej tij”.

Gjykata Kushtetuese konstaton se dy paragrafët e mësipërm në lidhje të ngushtë me nenin 43/1 të këtij ligji, lejojnë të bëhet ankim në gjykatë kundër vlerësimit tatimor, vetëm pasi personi i kontrolluar ta ketë paguar atë. E drejta e ankimit është element i procesit të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe e lidhur ngushtë me parimin e dëgjimit, parashikuar në nenin 33 të Kushtetutës. Ajo parashikohet si “ankim efektiv” në nenin 13 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Sipas kësaj të drejte, çdo individ mund t’i drejtohet instancave kombëtare, kur pretendon se është viktimë e një mase të marrë nga autoritetet shtetërore dhe që sipas tij vjen në kundërshtim me Kushtetutën, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe ligjet e brendshme. E drejta e ankimit presupozon të drejtën e qytetarit për t’iu drejtuar një organi më të lartë shtetëror, pranimin e ankimit, ekzistencën e organit për shqyrtimin e ankimit, afatet optimale të shqyrtimit, shqyrtimin objektiv, kontrollin gjyqësor si kontrollin përfundimtar ndaj ankimit dhe një garanci për një rehabilitim të mundshëm si pasojë e shqyrtimit dhe pranimit të ankimit.

Dispozitat objekt kërkesë kushtëzojnë të drejtën e ankimit me pagimin paraprak të vlerësimit tatimor, gjë që përbën kufizim të kësaj të drejte. Si çdo e drejtë subjektive, edhe e drejta e ankimit, nuk e përjashton mundësinë që ligjvënësi të vendosë kufizime në ushtrimin e saj për të mbrojtur një interes publik ose të drejtat e të tjerëve. Por, kufizimet mund të vendosen duke u përmbyshur kushtet garanci për mbrojtjen e të drejtave që parashikon neni 17 dhe pikërisht që kufizimi duhet të bëhet me ligj, të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë, të mos cenojë thelbin e të drejtës dhe të mos tejkalojë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, për shkak që ka parashtruar kërkesë Gjykata Kushtetuese nuk arrin në përfundimin se dispozitat objekt kërkesë janë antikushtetuese.

- Nga përmbajtja e dispozitave në shqyrtim rezulton se ligjvënësi synon ta detyrojë subjektin e tatuar që krahas me kërkesën për rishqyrtim në organet më të larta tatimore, të paguajë vlerësimin tatimor që i detyrohet shtetit. Kjo pagesë paraprake bëhet në përputhje me politikën shtetërore të grumbullimit të të ardhurave të ligjshme, me qëllim që shteti të përmbyshë funksionet e veta ndaj shoqërisë në përgjithësi e shtetasve në veçanti, pra është në interes publik.

- Gjykata Kushtetuese konstaton se nenet 41/4, 42/5 e 43/1 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, për aq sa parashtrohet në kërkesë, gjithashtu nuk cenojnë parimin kushtetues të përpjesëtimit midis kufizimit që i bëhet ankimit të subjektit të tatuar me gjendjen që e ka diktuar atë masë. Ligji ruan balancin midis të drejtës së individit dhe të mirës së përgjithshme, duke mbajtur një qëndrim të arsyeshëm në përcaktimin e vlerës që merret paraprakisht. Nga përmbajtja e ligjit del se organet tatimore jo vetëm që vlerësimin tatimor e bëjnë zakonisht kur personi i kontrolluar nuk respekton kushtet e ligjit për pagimin e TVSh-së, por dhe se ky vlerësim përfaqëson vetëm një pjesë të detyrimit tatimor që përfshin në vetvete edhe gjobën e interesin. Vetë vlerësimi tatimor përfaqëson shumën që i takon shtetit nga fitimi i subjektit që ushtron veprimtari tregtare.

Pagimi paraprak i vlerësimit tatimor është i nevojshëm për shkak të vështirësive që ndeshin organet shtetërore në vjeljen e detyrimeve nga subjektet e detyruara. Në kushtet e një ekonomie informale të vendit dhe kur transaksionet financiare janë në hapat e para, nga mosvjelja në kohë e detyrimeve mund të vijnë pasoja të tilla që do të dëmtonin rëndë interesat publike dhe do të prishnin balancin midis të mirës së përgjithshme dhe të drejtës së individit në favor të këtij të fundit.

Kufizimi është i përligjur edhe se qëllimi i ligjit është që shteti t’i marrë paraprakisht shumat që i takojnë, pa mohuar kthimin e tyre në rast se gjykata anulon aktin administrativ të organeve tatimore. Vetë ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të konceptit të shtetit ligjor e të vetë nocionit të gjyqimit të drejtë, prandaj neni 1 paragrafi i dytë i protokollit nr.1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, u jep të drejtë shteteve që duke respektuar parimin e ligjshmërisë dhe të legjitimitetit të kufizimeve “të venë në fuqi ligjet që ato i quajnë të domosdoshme për të siguruar pagesën e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave”.

- Kufizimi i së drejtës së ankimit në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, nuk tejkalon as kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Në nenin 13, Konventa përcakton të drejtën e ankimit efektiv pa u shprehur në këtë nen për kufizimin e kësaj të drejte, siç vepron për disa të drejta të tjera, por neni 1, paragrafi 2 i protokollit nr.1 të Konventës pranon të drejtën e shteteve të nxjerrin ligje për të siguruar pagesën e kontributeve. Nga ana tjetër, Konventa parashikon vetëm qëllimin e kufizimit që është sigurimi i pagesave nga subjektet, duke i lënë shteteve hapësirë vlerësimi për rrugët e mjetet efektive të realizimit të këtij qëllimi. Vetë ligji objekt kërkesë ka përcaktuar rrugët e mjetet e domosdoshme që sigurojnë pagesat e

kontributeve pa cenuar thelbin e të drejtës, duke parashikuar edhe disa mjete të tjera që mbrojnë thelbin e të drejtës, pra që i japin mundësi subjektit të tatuar që ka vështirësi financiare të ushtrojë ankimin. Kështu, ligji nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore” parashikon edhe zgjatjen e afatit të pagesës ose ndarjen e saj në këste, kur tatimpaguesi nuk mund të paguajë menjëherë të gjithë detyrimin tatimor. Jo vetëm kaq, por sipas udhëzimit nr.5, datë 11.2.2002 të Ministrit të Financave, tatimpaguesi mund të paraqesë edhe garanci të tjera të nevojshme para se të paraqitet për apelim.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash

#### V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.  
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### MENDIMI PARALEL

Ndryshe nga shumica, e cila vendosi rrëzimin e kërkesës në themel të Gjykatës së Lartë, unë isha i mendimit që kjo kërkesë duhej të përfundonte me vendim refuzimi.

Ky qëndrim i imi është i lidhur me faktin se kërkuesi, në rastin konkret, nuk legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. Në bazë të nenit 68 të ligjit organik të këtij të fundit, të gjitha gjykatat e zakonshme, ku bën pjesë edhe Gjykata e Lartë, nuk mund t’i kërkojnë asaj të shprehet për kushtetueshmërinë e ligjit ose të ndonjë akti tjetër normativ, i cili nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë ose nuk bëhet pengesë për zgjidhjen e një çështjeje konkrete që ndodhet pranë tyre për shqyrtim.

E parë në këtë këndvështrim, kërkesa objekt gjykimi ka në përmbajtje të saj shfuqizimin si antikushtetues të një ligji që Gjykata e Lartë është urdhëruar në mënyrë të shprehur me një vendim të mëparshëm të Gjykatës Kushtetuese që atë të mos e zbatojë dhe nuk ka asnjë ndalesë për të vazhduar shqyrtimin e çështjes. Megjithatë, ajo ka vendosur në bazë të nenit 45 të Kushtetutës, pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje në kundërshtim me përmbajtjen e vendimit të sipërm të Gjykatës Kushtetuese.

Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë duke mos iu përmbajtur kërkesave të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ka ngritur pranë kësaj Gjykate një çështje, e cila për arsyet që u përmendën më lart, nuk mund të zgjidhet në themel.

Në këto rrethana jam i mendimit vetëm për refuzimin e kësaj kërkesë për mungesë të legjitimitetit aktiv të Gjykatës së Lartë, pra pa i hyrë analizës së shkaqeve që ajo ka parashtruar për shfuqizimin si antikushtetuese të dispozitave të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, domethënë, pa u shprehur, ashtu siç veproi shumica nëse këto shkaqe janë ose jo të bazuara.

ANËTAR  
**Z. Vuci**

#### MENDIMI I PAKICËS

Kërkesa duhej pranuar, nenet 41/4.5; 42/5; 43/1 dhe 45 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe me Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

1. Thelbi i dispozitave të atakuara është ky: Subjektet (fizikë apo juridikë) lidhur me vlerësimet apo rivlerësimet e tatimit nuk mund të ankohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave në qoftë se nuk kanë paguar shumën e pagueshme të TVSh-së. Me fjalë të tjera, edhe pse afati

i pagimit është 30 ditë pas ditës së vlerësimit, në këto 30 ditë subjekti s'mund të bëjë ankim pa bërë pagesën e mësipërme.

Kuptimi i drejtë i thelbit të dispozitave të mësipërme ka rëndësi të veçantë, sepse si nga përfaqësuesit e subjektit të interesuar, ashtu dhe nga shumica kuptohen gabimisht si të lidhura ngushtë me efektet pezulluese të ankimit. Prej kësaj rrjedhin arsyetimet e shumicës lidhur me përpjesëtimin e kufizimit me gjëndjen që ka diktuar atë etj. Për më tepër shumica në vendimin e saj le të kuptohet se ky kufizim lejohet për të mbrojtur interesa të gjera publike.

Në të vërtetë, situata është shumë e qartë dhe jo e komplikuar sikurse ka tendenca për t'u paraqitur. Ankimi nuk pezullon ekzekutimin e akteve të organeve tatimore, përkundrazi me kalimin e 30 ditëve detyrimi do të arkëtohet, ka bërë apo s'ka bërë ankim subjekti.

2. Për zgjidhjen drejt të kërkesës gjykata duhej t'i referohej tërësisht Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut e jo nenit 17 të Kushtetutës sonë.

Neni 17 i Kushtetutës parashikon mundësinë e kufizimeve "të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë". Për pasojë e drejta e ankimit si e drejtë themelore duhet të jetë parashikuar në Kushtetutë e si rrjedhim kur plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 17 mund të kufizohet me ligj.

Në fakt ankimi ndaj akteve administrative është një ankim që ka dallime nga ankimi në gjykatë (neni 43 i Kushtetutës) apo dhe nga ankesa, kërkesa apo vërejtja (neni 48 i Kushtetutës). Ajo ka kuptimin e një "rekursi" sipas nenit 8 të Deklaratës. Në këto kushte "ankimi" si e drejtë themelore, më i plotë se kudo paraqitet në nenin 13 të Konventës. Nëse në ushtrimin e kësaj të drejte duhen vënë ose jo kufizime, kjo përsëri i përket Konventës, e cila në nenin 18 të saj duke vënë cakun e kufizimeve të të drejtave, e lidh kufizimin me të drejtën konkrete. Dihet që neni 13 për të drejtën për ankim efektiv nuk parashikon apo nuk lejon kufizime. Për pasojë kufizimi i pretenduar shkaktuar nga dispozitat e atakuara nuk gjen mbështetje edhe në Konventë.

Edhe sikur për një moment të pranohet se në rastin e dhënë duhej zbatuar neni 17 i Kushtetutës përsëri ky argument do të ishte në favor të tezës së pakicës. Kjo për shkak se Kushtetuta, lidhur me kufizimet, parashikon një sërë elementesh të cilat të marra bashkërisht mund të krijojnë premisa ligjore për kufizime. Në këtë drejtim shumica duket se nuk ka parasysh se midis elementeve të domosdoshëm për kufizimet është edhe se ato "nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventë...". Atëhere shtrohet pyetja: Në kushtet kur në Konventë për këtë të drejtë nuk ka fare kufizime, si mund të pranohet se janë zbatuar standardet e detyrueshme të saj?

Teza se një kufizim i tillë lejohet, në referim të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nuk qëndron. Është e vërtetë që dispozita e mësipërme autorizon nxjerrjen e ligjeve që sigurojnë pagesën e taksave, por dispozitat e atakuara nuk sigurojnë këtë. Objekt i shqyrtimit tonë është kufizimi i së drejtës së rekursit (ankimit) para afateve të caktuara për pagesë, rekurs që nuk pezullon pagesën. Ky rekurs në këtë fazë në një shtet me institucione serioze e të konsoliduara ka për qëllim mënjanimin në kohë të shkeljeve eventuale, i cili është mjaft i vështirë dhe shpesh i pamundur të realizohet mbas pagimit të parakohshëm të taksave e kalimit të tyre në Buxhetin e Shtetit.

ANËTAR  
A. Karamuço

## V E N D I M

### Nr. 10, datë 2.4.2003

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i ""

Gjergj Sauli, Anëtar i ""

Alfred Karamuço, Anëtar i ""

Kristofor Peçi, Anëtar i ""

Xhezair Zaganjori, Anëtar i “““

Petrit Plloçi, Anëtar i “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.2.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çëshjen nr.241/7 Akti që i përket:

KËRKUES: LULEZIM MURTHI, përfaqësuar nga avokate Valbona Kotorri, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: HAMDI, LIRI, HASAN E DHURATA FAJA, përfaqësuar nga Hamdi Faja, me deklaram.

BESIM, METIE, MYRTEZA, HAXHIRE, XHELAL, DILE E IRMA MURTHI, SI DHE YLLKA YLLI, MAJLINDA BEGA, ILIRJAN SPAHIU E VJOLLCA MUZHAQI, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.1050, datë 26.2.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nr.73, datë 26.7.2002 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134/g të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve gjyqësore:

- Nuk është thirrur në gjykimin e pjesëtimit të pasurisë, megjithëse është bashkëpronar;
- Dëshmia e trashëgimisë ku është bazuar gjykata është deklaruar e pavlefshme me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Legjitimiteti i drejtohej Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim, sepse subjektet e interesuara kanë fshehur provat në gjykimin në gjykatën e rrethit.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesve, subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi

#### V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë, ka pranuar kërkesën e paditësve Hamdi, Liri, Hasan e Dhurata Faja ngritur kundër të paditurve Besim, Metie, Myrteza, Haxhire, Xhelal, Dile e Irma Murthi; Yllka Ylli, Majlinda Bega, Ilirjan Spahiu e Vjollca Muzhaqi dhe ka lejuar pjesëtimin e tre trojeve duke caktuar pjesën ideale të secilës palë pjesëmarrëse në gjyq.

Nga materialet e çështjes rezulton se ajo gjykatë nuk ka thirrur si palë në gjyq dhe nuk i ka caktuar pjesë kërkuesit Lulëzim Murthi, sepse është bazuar në dëshminë e trashëgimisë nr.1802, datë 18.10.1993 të lëshuar nga zyra noteriale Tiranë, në të cilën kërkuesi nuk figuronte si trashëgimtar ligjor i trashëgimlënësit Maliq Murthi dhe në dokumentet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në të cilat kërkuesi nuk ishte i regjistruar si bashkëpronar në kohën e zhvillimit të gjykimit.

Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit të fazës së parë të pjesëtimit të pasurisë duke paraqitur si provë vendimin nr.26, datë 16.11.1956, me të cilin trashëgimlënësi Maliq Murthi, është njohur si i ati i tij. Ai ka paraqitur gjithashtu kopje të vendimit nr.2224, datë 3.6.1998 të Gjykatës së rrethit Tiranë, me të cilën është deklaruar si e pavlefshme dëshmia e trashëgimisë me nr.1802, datë 18.10.1993 për pjesën e trashëgimtarëve ligjorë të Maliq Murthit, duke përcaktuar si të tillë edhe kërkuesin. Megjithatë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.73, datë 26.7.2002 nuk ia ka pranuar kërkesën me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohet të kundërshtojë atë vendim, përderisa nuk ka qenë palë në gjykim.

Kërkuesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij për një proces të rregullt ligjor, në kuptimin kushtetues. Nga vendimi i gjykatës së rrethit dhe nga ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, del se kërkuesi nuk ka qenë palë në gjykimin në gjykatën e rrethit, në të cilën pretendon se i është mohuar bashkëpronësia dhe sipas parimeve procedurale, ai vendim nuk mund të ketë efekte juridike për kërkuesin. Si rrjedhojë, këtij të fundit nuk i është mohuar e drejta të ngrejë padi themeli në gjykatë për çdo mohim të së drejtës së tij të bashkëpronësisë.

Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime, për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë gjykatë, vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelineve.

Veç sa më sipër, Gjykata Kushtetuese, nuk mund të mos vërë në dukje që procesi ligjor i zhvilluar nga gjykatat është i rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Fakti që provat e reja të paraqitura pas gjykimit dëshmojnë se kërkuesi është bashkëpronar në pasurinë trashëgimore nuk mund ta bëjnë procesin të parregullt, përderisa nuk del që gjykatat të kenë neglizhuar si për marrjen e provave, ashtu edhe për thirrjen në gjyq të personave që pretendojnë për bashkëpronësi.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

#### V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.  
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### V E N D I M Nr.11, datë 2.4.2003

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu, Kryetar i Gjykatës Kushtetuese

Zija Vuci, Anëtar i “““

Alfred Karamuço, Anëtar i “““

Kristofor Peçi, Anëtar i “““

Kujtim Puto, Anëtar i “““

Xhezair Zaganjori, Anëtar i “““

Sokol Sadushi, Anëtar i “““

Gjergj Sauli, Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalice, në datë 17.01.2003, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.251/9 Akti që i përket:

KËRKUES: ARJAN ALIAJ, përfaqësuar nga avokatët Artan Zeneli e Fatmir

Tartale, me deklaram.

SUBJEKT I INTERESUAR: KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË, përfaqësuar nga Edmond Islamaj, kryeinspektor e Urim Bejleri, inspektor, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetuese të vendimeve nr.99, datë 20.12.2000 të

Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.25, datë 4.4.2001 të Kolegjeve të

Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Për shfuqizimin si antikushtetuese të këtyre vendimeve, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë është marrë në kundërshtim me nenin 33 të Kushtetutës, sepse kërkuesi nuk është njoftuar për t'u dëgjuar në seancën e shqyrtimit të çështjes;

- Ndaj kërkuesit është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor, sepse nuk i është krijuar mundësia që të mbrojtë të drejtat e njohura nga Kushtetuta dhe ligji “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;

- Në marrjen e masës disiplinore për kërkuesin, Këshilli i Lartë i Drejtësisë është bazuar në vlerësimin negativ të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të dhëna prej tij si gjyqtar;

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vepruar në kundërshtim me nenet 17 e 44 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", sepse:

Shkeljet e konstatuara në vendimet gjyqësore nuk i ka evidentuar nëpërmjet ankesave të shtetasve;

Shkeljet që lidhen me vendimin nr.61, datë 13.10.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nuk i ka përfshirë në kërkesën për procedim disiplinor.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gjergj Sauli, kërkuesin e përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi

## V Ë R E N:

Me vendimin nr.99, datë 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kërkuesi Arjan Aliaj është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit të shkallës së parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me motivacionin e kryerjes së veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës.

Kundër vendimit të sipërm kërkuesi paraqiti ankim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat me vendimin nr.25, datë 4.4.2001, vendosën rrëzimin e ankimit.

Gjatë shqyrtimit të çështjes nga Gjykata Kushtetuese, rezultoi se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në marrjen e vendimit për shkarkimin e kërkuesit nga detyra, ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës. Ai nuk i ka siguruar kërkuesit mundësinë për t'u dëgjuar e mbrojtur në seancën e shqyrtimit të çështjes, gjë që ka prekur të drejtat e tij, të njohura nga Kushtetuta dhe ligji "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesi Arjan Aliaj nuk është njoftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e datës 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, as nëpërmjet shpalljes së vendosur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, as nëpërmjet avokatit të tij ose fluesit të gjykatës.

Nga provat e administruara në seancë gjyqësore rezultoi se kërkuesi, me shpalljen e vendosur në gjykatë në datën 30.11.2000, njoftohej për t'u paraqitur pranë Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për komunikimin e materialeve të procedimit disiplinor të filluar nga Ministri i Drejtësisë dhe jo për datën e shqyrtimit të çështjes.

Nga deklarata e lëshuar prej fluesit gjyqësor, rezultoi se kërkuesi nuk është njoftuar për datën e shqyrtimit të çështjes, sepse në deklaratë thuhet që fluesi kishte marrë përsipër t'i dorëzonte kërkuesit vetëm materialet e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Njoftimi i kërkuesit për datën e shqyrtimit të çështjes nuk është bërë as nëpërmjet avokatit. Gjatë gjyqimit rezultoi se kërkuesi nuk kishte caktuar avokat për ta përfaqësuar. Nuk u tregua emri i avokatit që pretendohet se kishte marrë përsipër të bënte njoftimin dhe nuk u shfaq ndonjë dyshim që kërkuesi, largimin nga Shqipëria ta kishte bërë për t'u fshehur shqyrtimit të çështjes.

Në kushtet e mësipërme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka vepruar në kundërshtim me nenin 33/1 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, në të cilat është sanksionuar parimi i së drejtës që ka çdo person që të dëgjohet përpara se të gjykohet. Ai ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 44 të ligjit "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" që parashikon detyrimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë që në çdo rast të procedimit disiplinor, të dëgjojë në seancë pretendimet e gjyqtarit, i cili ka të drejtë të mbrohet vetë ose me avokat.

Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e kërkuesit nga detyra, është mbështetur në vlerësimin negativ që i ka bërë grupi i inspektorëve 11 vendimeve gjyqësore të dhëna prej tij. Në këtë mënyrë, ky Këshill ka hyrë në vlerësimin e ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve gjyqësore të dhëna prej kërkuesit, sepse këto vlerësime, kryesisht, janë bërë për zbatim të gabuar të ligjit, për caktimin e masave të buta të dënimit, për mosvlerësim të drejtë të rrezikshmërisë shoqërore të veprës, si dhe për mosvlerësim të drejtë të personalitetit të autorit të veprës.

Sipas nenit 135 të Kushtetutës, pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykata e apelit dhe gjykata e shkallës së parë. Ky pushtet ushtrohet i shkallëzuar sipas parimit të kontrollit të vendimeve të gjykatave më të ulëta nga gjykatat më të larta. Kjo do të thotë se përderisa vendimet nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror, qoftë edhe Këshilli i

Lartë i Drejtësisë, nuk ka të drejtë t'i prekë ato dhe as të ngarkojë me përgjegjësi disiplinore gjyqtarin e çështjes për këto vendime.

Përgjashtim nga rregulli i mësipërm, bëhet vetëm për rastet kur vendimet janë rrjedhojë e shkeljeve që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit. Në këto raste, shkeljet duhet të evidentohen dhe argumentohen para se të merret masa disiplinore e largimit të gjyqtarit nga detyra. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, kur vërtetohen shkelje të natyrës së mësipërme, mund të veprojë në çdo kohë për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit, pavarësisht nëse çështja ka përfunduar ose jo. Këto konkluzione Gjykata Kushtetuese i ka nxjerrë edhe në vendimin e saj nr.29, datë 30.4.2001, që i përket kërkesës Ardian Kalia.

Gjykata Kushtetuese, për çështjen në gjykim, vëren se Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e shkeljeve disiplinore që i atribuohen kërkesës. Ata nuk janë shprehur nëse këto akte ose shkelje janë kryer si rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e tij si gjyqtar apo janë shkelje e gabime të një natyre më të lehtë që mund të kenë ardhur nga neglizhenca, paaftësia profesionale ose nga mungesa e përvojës në detyrë.

Qartësimi i këtyre rrethanave që përbën një detyrim kushtetues për Këshillin e Lartë të Drejtësisë në kuptim edhe të nenit 147 të Kushtetutës, ka qenë tepër i nevojshëm, sepse kërkesi është ngarkuar me përgjegjësi nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për shkelje të tilla që kanë të bëjnë kryesisht me zbatimin e gabuar të ligjit ose me dhënien e dënimeve të buta.

Në rrethanat që paraqitet çështja, vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë duhet të shfuqizohet për shkak të zhvillimit të një procesi jo të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42/1 të Kushtetutës. Po kështu, duhet të shfuqizohet si antikushtetues edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, sepse atyre u janë parashtruar shkelje që përbëjnë proces të parregullt ligjor dhe që nuk i kanë ndrequr.

Përsa më sipër, çështja duhet të kalojë për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Për shkaqet e tjera të paraqitura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese çmon se ato nuk kanë ndikuar në dhënien e vendimeve objekt gjykimi, prandaj nuk i quan të bazuara.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

#### **V E N D O S I:**

- Shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve nr.99, datë 20.12.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe nr.25, datë 4.4.2001 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

#### **V E N D I M Nr.1, datë 30.1.2003**

#### **NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo KondiKryetar

Perikli ZahariaAnëtar

Kristaq NgjelaAnëtar

Spiro SpiroAnëtar

Agron LamajAnëtar

Artan HoxhaAnëtar

Natasha SheshiAnëtare  
Metush SaraçiAnëtar  
Nikoleta KitaAnëtare  
Zamir PodaAnëtar  
Valentina KondiliAnëtare  
Vladimir MetaniAnëtar  
Vladimir BineriAnëtar  
Irma BalaAnëtare

në seancën gjyqësore të datës 30.1.2003 morën në shqyrtim çështjen civile me palë:

KËRKUES: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori  
Bilbil Mete.

OBJEKTI: Njohje e vendimit penal të Gjykatës së Parë Penale të Apelit të Milanos Itali, nr.6/01 e nr.39/00, datë 2.2.2001, në ngarkim të shtetasit shqiptar Arben Grori.

Baza ligjore: Neni 512 i Kodit të Procedurës Penale.

I dënuari Arben Grori përfaqësohet nga avokatët Vladimir Meçe e Mark Pëllumbi.

Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendimin nr.555, datë 20.6.2002 ka vendosur:

Mospranimin e kërkesës së Prokurorisë së Përgjithshme për njohjen e vendimit penal nr.6/01 dhe nr.39/00, datë 2.2.2001 të Gjykatës së Parë Penale të Apelit të Milanos Itali.

Gjykata e Apelit Tiranë, mbi apelin e prokurorit, me vendimin nr.384, datë 24.7.2002, ka vendosur:

Lënen në fuqi të vendimit nr.555 akti, datë 20.6.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kundër vendimeve të mësipërme, ka bërë rekurs Prokuroria e Përgjithshme, e cila kërkon ndryshimin e vendimeve dhe pranimin e kërkesës për njohjen e vendimit penal të huaj, për arsyet e mëposhtme:

Nuk ekziston asnjë shkak ligjor për mosnjohjen e vendimit penal të autoriteteve gjyqësore italiane për dënimin e Arben Grorit.

- Germa “e” e nenit 514, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, që parashikonte kushtin absurd të pëlqimit të të dënuarit ose të përfaqësuesit të tij ligjor, është shfuqizuar me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002 dhe ky ligj ka qenë në fuqi në momentin e gjykimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Tiranë.

- Gjykatat kanë vendosur në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 3, 4, 5, 6 e 21 të saj, pasi, nëse ato çmonin se për njohjen e vendimit të autoriteteve gjyqësore italiane bëhej pengesë germa “e” e nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale, në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës, duhet të pezullonin gjykimin dhe t’ia dërgonin çështjen Gjykatës Kushtetuese, pasi nuk mund të mos vlerësohej se përmbajtja e kësaj dispozite binte ndesh me ligjin themelor të shtetit.

- Gjykatat kanë vepruar në kundërshtim me vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.154, datë 15.4.2000, pasi kushtet e përmendura në këtë vendim ekzistojnë plotësisht në rastin objekt gjykimi.

- Gjykata e apelit ka shkelur parimin e njohur dhe të pranuar botërisht për zbatimin e ligjit procedural penal “tempus regit actum”, sipas të cilit zbatohen ato dispozita procedurale që janë në fuqi në kohën e gjykimit të çështjes dhe përjashtim nga ky rregull është vetëm rasti kur ligjvënësi përcakton afate për aplikimin e ligjit procedural penal.

- Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së apelit arrihet në përfundimin absurd se autorët e krimit kanë vetëm të drejta e jo detyrime dhe se vendimet e autoriteteve gjyqësore të huaja në Shqipëri janë të pazbatueshme, fakt që flet se kjo gjykatë ka mbajtur anën e mbrojtjes, duke shkelur parimin e paanësisë në gjykim.

- Arsyet e gjykatës së apelit janë deduksione hipotetike e të pambështetura në dispozitat e posaçme të ligjit procedural penal.

Me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore bazuar në nenin 438 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 14 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur tërheqjen e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara. Ky vendim është marrë nisur nga fakti se, lidhur me këtë kategori çështjesh, në praktikën e gjykatave të rretheve gjyqësore e të apeleve kanë lindur probleme përsa i përket kuptimit, interpretimit e zbatimit të dispozitave të titullit X, kreut III, seksioni I të Kodit të Procedurës Penale, që rregullojnë ekzekutimin e vendimeve penale të huaja (nenet 512 – 518). Në mënyrë të veçantë ka lindur e nevojshme të sqarohen e të njësohen qëndrimet për problemet e

mëposhtme:

1. Në marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale, cilat norma kanë përparësi në zbatim, ato të marrëveshjeve ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar ose parimet e normat përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare, apo ato të legjislacionit të brendshëm kombëtar?

2. Cili është dallimi midis: 1) transferimit të të dënuarve, që janë dënuar dhe vuajnë dënimin në një shtet të huaj, në shtetin e tyre të origjinës, d.m.th. në shtetin, shtetas të të cilit ata janë; 2) ekzekutimit të vendimit penal të huaj ndaj një shtetasi shqiptar të dënuar, që ndodhet pas dhënies së dënimit në territorin e Republikës së Shqipërisë; 3) ekstradimit?

3. Në varësi të qënies ose jo nën kufizim të lirisë së një të dënuari me burgim, shtetas shqiptar, si rezultat i një vendimi penal të huaj, a jemi para proceseve të ndryshme ekzekutimi dhe, për efekt të këtij ekzekutimi, në njohjen e vendimit penal të huaj, a përbën kusht për njohje pëlqimi i të dënuarit në të gjitha rastet?

Dhënia e pëlqimit të të dënuarit prej gjykatës së huaj duhet për faktin nëse ai dëshiron ta vuajë apo jo dënimin (siç pranon gjykata e rrethit dhe ajo e apelit), apo se ku dëshiron ta vuajë dënimin, në burgjet e shtetit dënues, apo në burgjet e shtetit, shtetas i të cilit ai është?

4. Për problemet e mësipërme a ka ndeshje midis dispozitave të konventave dhe dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë.

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Thimjo Kondi e Kristaq Ngjela, pasi dëgjuan prokurorin Bilbil Mete, që kërkoi prishjen e të dy vendimeve dhe njohjen e vendimit të Gjykatës së Apelit të Milanos - Itali, avokatët Vladimir Meçe e Mark Pëllumbi që kërkuan lënien në fuqi të vendimeve e pasi e biseduan çështjen në tërësi,

#### V Ë R E J N Ë:

Vendimi nr.384, datë 24.7.2002 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr.555, datë 20.6.2002 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përkasin të dënuarit Arben Grori, janë të pabazuar në ligj, prandaj duhet të prishen dhe çështja të dërgohet për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga aktet e gjykimit në shkallë të parë e në apel ka rezultuar si më poshtë:

Gjykata e Pestë Penale e Milanos në Republikën e Italisë me vendimin e datës 21.12.1999 ka vendosur deklarimin fajtor dhe dënimin me burgim të përjetshëm të shtetasit shqiptar Arben Grori, për krimet e parashikuara nga nenet 110, 575, 577/3 etj. të Kodit Penal Italian.

Vendimi i mësipërm është konfirmuar me vendimin nr.6/01 dhe nr.39/00 të regj.përgj., të Apelit të Milanos në Republikën e Italisë.

Kundër vendimeve të mësipërme është ushtruar rekurs në Gjykatën e Kasacionit të Republikës së Italisë, i cili është hedhur poshtë me sentencën e datës 30.1.2002 të seksionit të parë të asaj gjykate.

Duke qenë se shtetasi shqiptar Arben Grori është gjykuar e dënuar në mungesë dhe, sipas të dhënave që kishin autoritetet italiane, ai ndodhej në territorin e Republikës së Shqipërisë, ato kanë kërkuar njohjen e vendimit penal të mësipërm nga autoritetet gjyqësore shqiptare. Ministria e Drejtësisë e Italisë ia ka përcjellë dokumentacionin e nevojshëm Ministrisë së Drejtësisë të Shqipërisë dhe kjo e fundit, Prokurorisë së Përgjithshme, e cila, konform nenit 512/1 të Kodit të Procedurës Penale, ka vënë në lëvizje Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk e ka pranuar këtë kërkesë për njohjen e vendimit penal të huaj me arsyetimin se ekzistonte pengesa ligjore e parashikuar në nenin 514, pika “e”, të Kodi i Procedurës Penale, sipas të cilit “Vendimi i gjykatës së huaj nuk mund të njihet kur: ...

e – nuk është dhënë pëlqimi nga i dënuari ose përfaqësuesi ligjor i tij”.

Kjo gjykatë në arsyetimin e vendimit të saj u referohet edhe disa vendimeve të Gjykatës së Lartë, që kanë të bëjnë me probleme të ekstradimit dhe të transferimit të personave të dënuar nga shteti ku vuajnë dënimin në shtetin, shtetas të të cilit ata janë.

Lidhur me sa më lart, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se referencat në praktikën e kësaj gjykate, të parashtruara në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, janë të gabuara. Këto vendime nuk japin zgjidhje për çështjen në fjalë, sepse problematika në shqyrtim është e ndryshme.

Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj shprehet në mënyrë të përgjithshme se kërkesa e prokurorisë për njohjen e vendimit penal të gjykatës së huaj është e papranueshme, sepse, sipas saj, ajo bie ndesh me parimet e sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në Konventat Ndërkombëtare, ku Shqipëria ka aderuar apo është palë, si dhe në Kodin Penal e në Kodin e Procedurës Penale. Megjithatë kjo gjykatë nuk bën ndonjë analizë në bazë të atyre parimeve. Madje nuk kuptohet fare se për cilat parime bëhet fjalë.

Në pjesën e fundit të vendimit të saj gjykata e apelit përmend edhe njëherë në mënyrë të përgjithshme ekzistencën e parimeve bazë të kreut të Kushtetutës “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, si dhe u referohet neneve 3 e 15 e vijues të Kushtetutës, nenit 3/3 të Kodit Penal, si dhe nenit 10 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit “Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare, të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij kodi”.

Gjykata e Apelit Tiranë konstaton me të drejtë se shteti shqiptar dhe shteti italian ende nuk kanë lidhur ndonjë marrëveshje për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, por arsyetimi i saj për normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare, si dhe normat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim, është tërësisht dhe qartësisht i gabuar, mbështetur nga argumentet që do të parashtrijmë më poshtë në këtë vendim.

Gjykata e apelit në vendimin e saj përmend parimin e moskeqësimit të pozitës së të pandehurit, si dhe detyrimin e gjykatës për të zbatuar dispozitat favorizuese. Kjo gjykatë jo vetëm që i përmend përciptazi dhe në mënyrë jokorrekte këto parime, por, për më tepër, ato nuk kanë lidhje me lëndën në shqyrtim.

Në mënyrë të veçantë Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë nuk mund të pajtohet me pohime të tilla si: “... janë pranuar këto parime edhe në të drejtën ndërkombëtare, por që nga gjyqtarët e huaj nuk mbahen parasysh kur ata deklarojnë fajtorë dhe japin dënime të rënda për shtetasit shqiptarë, krahasuar me ato të dhëna shtetasve të tyre të dënuar për të njëjtat vepra penale”.

Konkluzione të tilla jo vetëm që nuk bazohen në fakte e argumente dhe nuk mund të bindin askënd, por, për më tepër, ato nuk kanë kurrfarë lidhje me natyrën e përmbajtjen e një vendimi gjyqësor. Shprehje të tilla janë diskretituese për figurën e gjyqtarit dhe ulin kredibilitetin e drejtësisë shqiptare, prandaj i bëhet vërejtje gjykatës së apelit, me qëllim që këto dukuri të mos përsëriten më në të ardhmen.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konkludojnë se të dy vendimet duhet të prishen për zbatim të gabuar të ligjit procedural mbështetur në arsyetimin si më poshtë:

1. Që në kohën e miratimit të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” është pranuar se “Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare” (neni 8/1). Me miratimin e Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr.7905 datë 21.3.1995, në nenin 10 të tij u parashikua në mënyrë të shprehur se “Marrëdhëniet me autoritetet e huaja në fushën penale rregullohen nga marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar, nga parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare, si dhe dispozitat e këtij kodi”.

Deri në miratimin dhe hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ekzistonte vetëm një angazhim i shprehur dhe i përgjithshëm për të zbatuar parimet e normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare, në këtë kuadër edhe normat që rregullojnë marrëdhëniet juridiksionale midis shteteve në fushën penale e procedurale penale, si dhe për të ndërtuar e përshtatur të gjithë legjislacionin në këto norma e parime.

Në nenin 5 të Kushtetutës është parashikuar se “Republika e Shqipërisë zbaton të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për të”.

Nenet 116/b, c dhe 122 të Kushtetutës parashikojnë në mënyrë të shprehur se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe të botuara në Fletoren Zyrtare përbëjnë pjesë të sistemit të brendshëm juridik, se ato zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk janë të vetëzbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji, dhe se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj kanë epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me to.

Nga sa më lart rezulton se në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në fushën penale përparësi ka Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, pajtueshmëria (kompatibiliteti) e të cilave me Kushtetutën mund të vlerësohet nga Gjykata Kushtetuese para ratifikimit të tyre (neni 131/b i Kushtetutës).

Duke qenë se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara kanë epërsi mbi ligjet e vendit, atëherë, në rast papajtueshmërie, kuptohet që gjykatat duhet të zbatojnë normat e marrëveshjes ndërkombëtare dhe jo të ligjit që nuk pajtohet me të.

2. Lidhur me zbatimin e vendimeve penale me kufizim të lirisë së një të dënuari, si dhe së masave shtrënguese penale që kufizojnë lirinë e një personi, në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara (Konventat e Këshillit të Europës) dhe në Kodin e Procedurës Penale, parashikohen: a) Transferimi në shtetin e origjinës (në shtetin, shtetas të të cilit janë) i të dënuarve, që janë dënuar dhe vuajnë dënimin penal me burgim në një shtet të huaj; b) Ekzekutimi nga autoritetet shqiptare i një vendimi penal të dhënë nga një gjykatë e huaj ndaj një shtetasi shqiptar të dënuar, që ndodhet pas dhënies së dënimit në territorin e Republikës së Shqipërisë; c) Ekstradimi.

Ekstradimi për jashtë shtetit sipas nenit 488 të Kodit të Procedurës Penale, është dorëzimi i një personi një shteti të huaj për ekzekutimin e një vendimi me burgim ose të një akti që vërteton procedimin e tij për një vepër penale.

Në këtë rast procedimi penal dhe/ose dënimi me burgim i personit, që ndodhet në Shqipëri dhe që kërkohet të ekstradohet, është bërë në shtetin e huaj që kërkon ekstradimin.

Ndërsa ekstradimi nga jashtë shtetit është marrja në dorëzim prej autoriteteve kompetente të huaja të një personi të proceduar ose të dënuar penalisht, ndaj të cilit duhet të ekzekutohet një masë që kufizon lirinë personale në territorin e Republikës së Shqipërisë (neni 504 i Kodit të Procedurës Penale).

Ekstradimi, në të dy format e sipërpërmendura, nuk ka të bëjë me çështjen në shqyrtim, por sqarimi i kuptimit të tij ka rëndësi për ta dalluar prej ekzekutimit të një vendimi penal të huaj nga autoritetet shqiptare dhe prej transferimit të të burgosurve shqiptarë nga një shtet i huaj, në Shqipëri.

3. Të dy këto masa me karakter proceduralo-penal gjejnë rregullim të përgjithshëm në nenet 512 – 518 të Kodit të Procedurës Penale, nën titullin e përbashkët “Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja”.

Transferimi i të burgosurve ka gjetur rregullim edhe në Konventën Europiane “Për transferimin e personave të dënuar me heqje lirie” të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë e të botuar në Fletoren Zyrtare nr.22 të vitit 1999, si dhe në disa marrëveshje bilaterale me shtete të tjera, ndërsa Konventa e Këshillit të Europës “Për vlerën ndërkombëtare të gjykrimeve penale” është nënshkruar nga shteti shqiptar, por ende nuk është ratifikuar nga Kuvendi. Si e tillë kjo Konventë nuk mund të konsiderohet pjesë e sistemit juridik (legjislacionit) të brendshëm dhe nuk mund të ketë aplikim të drejtpërdrejtë. Megjithatë fakti i nënshkrimit të kësaj Konvente, si dhe miratimi i dispozitës angazhuese sipas të cilës shteti njej dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare, na ndihmojnë për të kuptuar, interpretuar dhe zbatuar drejt dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që kanë lidhje me çështjen në shqyrtim. Këto dispozita nuk mund të kuptohen e të interpretohen ndryshe, veçse sipas kuptimit dhe përmbajtjes së parimeve e normave të gjithëpranura të së drejtës ndërkombëtare dhe të konventave ndërkombëtare.

Rregullimi ligjor në lidhje me njohjen e vendimeve penale të gjykatave të huaja bëhet me anë të dispozitave të neneve 512 – 518 të Kodit të Procedurës Penale, që përfshihen në seksionin e I-rë të kreut të III-të të këtij kodi dhe që titullohet “Ekzekutimi i vendimeve penale të huaja”. Rëndësi për trajtimin e rastit objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, kanë sidomos dispozitat e neneve 512 dhe 514 të Kodit të Procedurës Penale, në të cilat bëhet fjalë, respektivisht, për njohjen e vendimeve penale të huaja dhe për kushtet e kësaj njohjeje.

Nga përmbajtja e dispozitës së nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale, rezulton se bëhet fjalë për njohjen e vendimeve penale të dhëna nga gjykatat e huaja ndaj shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj ose personave pa shtetësi, por, të cilët në kohën kur kërkohet të bëhet njohja, që janë me banim në shtetin shqiptar. Procedimi penal i këtyre personave mund të ketë nisur në shtetin e huaj ose edhe në shtetin shqiptar, por, në të dy rastet, të jetë bërë nga një gjykatë e huaj.

Nevoja e njohjes së vendimeve penale të gjykatave të huaja, nga gjykatat shqiptare, lind vetëm në rastet kur i dënuari është shtetas shqiptar, ndërsa kur ai është shtetas i huaj apo person pa shtetësi, problemi, sikurse u trajtua më lart, zgjidhet nëpërmjet ekstradimit.

Duke u nisur nga përmbajtja e pikës 1 të dispozitës së nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës, Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë, por me banim në shtetin shqiptar, ndjek procedurat e parashikuara, po në këtë dispozitë, që nevojiten për njohjen e këtyre vendimeve në Shqipëri, arrihet në përfundimin se këtu bëhet fjalë si për

të dënuarit, shtetas shqiptarë, vendimi penal i dhënë për të cilët ka filluar të vihet në ekzekutim në shtetin e huaj, ashtu edhe për të dënuarit, shtetas shqiptarë për të cilët, vendimi penal i formës së prerë nuk ka filluar ende të vihet në ekzekutim.

Njohja e vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të huaja për kategorinë e parë, domethënë për të dënuarit shqiptarë, kur ka filluar në fakt ekzekutimi i tyre në shtetin e huaj, kërkohet dhe bëhet, si rregull, me qëllim që i dënuari të vazhdojë vuajtjen e pjesës së pavuajtur të dënimit, në Shqipëri.

Kurse njohja e vendimeve penale të formës së prerë të gjykatave të huaja për kategorinë e dytë, domethënë, për të dënuarit, shtetas shqiptarë, për të cilët vendimi penal i formës së prerë nuk ka filluar të vihet në ekzekutim dhe që janë me banim në shtetin shqiptar, si rregull, bëhet kur kërkohet për të dënuar të cilët ose janë dënuar në mungesë nga gjykata e huaj, ose duke qenë në gjendje të lirë, pas dënimit, kanë lënë vendin e huaj dhe kanë ardhur në Shqipëri. Në këtë kategori, duhet të përfshihen edhe të dënuarit, shtetas shqiptarë, të cilët, megjithëse vendimi penal ndaj tyre ka filluar të vihet në ekzekutim në shtetin e huaj, vuajtja e mëtejshme e dënimit, atje, është ndërprerë, pavarësisht nga shkaku (arratisja e të dënuarit nga burgu, moskthimi i tij nga leja etj.).

Edhe neni 514 i Kodit të Procedurës Penale, që titullohet “Kushtet e njohjes [së një vendimi penal të huaj]” dhe që parashikon në mënyrë taksative rastet kur një vendim penal i huaj nuk mund të njihet nga gjykatat shqiptare, përfshin në rregullimin e tij të dy format (rastet) e njohjes: a) Konvertimin e dënimit penal të dhënë nga një gjykatë e huaj kundër një shtetasi shqiptar, që është duke e vuajtur atë dënim në shtetin e huaj, kur ky i dënuar ka kërkuar që atë dënim ta vuajë ose të vazhdojë ta vuajë në të ardhmen në shtetin e tij; b) Njohjen dhe ekzekutimin e një vendimi penal të dhënë nga një gjykatë e huaj kundër një shtetasi shqiptar (ose edhe shtetasi të huaj ose personi pa shtetësi) me banim në Shqipëri. Në rastin e dytë shtetasi shqiptar nuk mund të ekstradohet pa pëlqimin e tij në shtetin që ka dhënë kundër tij një dënim penal, në mungesë të një marrëveshjeje bilaterale, që lejon ekstradimin edhe kundër vullnetit të tij.

Në rastin e parë pëlqimi i personit të dënuar është i domosdoshëm dhe përbën kusht sine qua non për transferimin e tij në shtetin e origjinës, në pajtim me nenin 3 pika “d” të Konventës Europiane “Për transferimin e personave të dënuar me heqje lirie”, si dhe me nenin 514 pika “e” (para shfuqizimit) të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë. Përsa i përket rastit të transferimit të të dënuarve, shfuqizimi i pikës “e” të nenit 514 i bie ndesh dispozitës së sipërpërmendur të Konventës, duke krijuar një papajtueshmëri. Megjithatë në këtë rast kjo nuk sjell efekte negative në praktikë, sepse, siç e kemi përmendur edhe më lart, konventa është direkt e zbatueshme si pjesë e sistemit juridik të brendshëm dhe zbatimi i saj ka përparësi ndaj Kodit të Procedurës Penale.

Në rastin e dytë, d.m.th. të njohjes dhe ekzekutimit të një vendimi penal të huaj, referimi në, dhe zgjidhja e çështjes sipas pikës “e” të nenit 514 të Kodit të Procedurës Penale, në kohën kur kjo ishte në fuqi, do të përbënte një nonsens. Në zgjidhjen që do të pranonte si domosdoshmëri pranimin edhe në këtë rast të pëlqimit të personit të dënuar do të na çonte vetëm interpretimi gramatikor (ad literam) i kësaj dispozite, ashtu siç ka vepruar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit. Mirëpo, interpretimi i një dispozite ligjore është kompleks. Sidomos në rastet kur interpretimi fillestar gramatikor mund të çojë në një nonsens, përparësi merr interpretimi logjik e sistematik. Sipas këtij interpretimi, dispozitës në fjalë do t’i jepet ai kuptim që është i arsyeshëm. Kjo do të thotë që nocionit të “pëlqimit të të dënuarit” nuk mund t’i jepet kuptim i gjerë që të përfshijë të dy rastet e njohjes së vendimit penal të huaj, por kuptim i ngushtë, që të përfshijë vetëm një rast, d.m.th. atë që nuk të çon në një absurditet, sikurse do të ishte dhënia e pëlqimit nga i dënuari për të vuajtur dënimin penal në shtetin e tij, sikurse në rastin e të dënuarit Arben Grori, i cili siç del nga aktet, gjykimi i tij është zhvilluar në mungesë, pasi ai iu shmang drejtësisë italiane.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e vlerësojnë të drejtë arsyetimin e prokurorëve si më poshtë: “... ekzekutimi i vendimit penal të huaj është një formë e marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e huaja, qëllimi kryesor i të cilit është parandalimi i personit të dënuar për t’i shpëtuar vuajtjes së dënimit. Në rast se do të pranohej pëlqimi i të dënuarit si kusht për të njohur vendimin penal të huaj, atëherë ky vendim do të bëhej i pazbatueshëm dhe do të minohej qëllimi kryesor i dispozitave të kreut të Kodit të Procedurës Penale të ekzekutimit të vendimeve penale dhe fryma e marrëdhënieve juridiksionale me shtetet e huaja. I dënuari nuk mund të pyetet se a ka dëshirë të vuajë dënimin, por vetëm se ku ka dëshirë ta vuajë atë. Në të kundërt jemi para një paradoksi, pasi asnjë i dënuar nuk do të pranonte me dëshirë që të shkonte në burg për të vuajtur dënimin, dhe aq më tepër dënimin me

burgim të përjetshëm.

... shteti italian është në pamundësi të ekzekutimit të vendimit penal objekt njohjeje, pasi i dënuari Arben Grori është shtetas shqiptar dhe nuk mund të ekstradohet. Në rast mosnjohjeje të këtij vendimi, atëherë ngelet që Shqipëria të kthehet në vend të qetë e të sigurt për të gjithë të dënuarit, që kryejnë krime jashtë vendit tonë dhe që arrijnë të futen sërish në Shqipëri...”

Dhënia e pëlqimit të një personi të dënuar penalisht prej një gjykate të huaj është kusht i domosdoshëm vetëm për të përcaktuar nëse dënimi do të kryhet në shtetin ku është kryer krimi, është gjykuar çështja dhe është dhënë dënimi apo në shtetin e origjinës së të dënuarit, d.m.th. në burgjet e shtetit, shtetas i të cilit ai është.

Ky është një parim i njohur dhe i gjithëpranuar në konventat ndërkombëtare dhe kjo frymë përshkon kuptimin e përmbajtjen e dispozitave përkatëse të Kodit tonë të Procedurës Penale në tërësi. Për analogji, kjo linjë është ndjekur edhe në nenin 519 të Kodit të Procedurës Penale, që rregullon kushtet e ekzekutimit jashtë shtetit të një vendimi penal të një gjykate shqiptare.

Nga përmbajtja e nenit 519/3 të Kodit të Procedurës Penale rezulton se pëlqimi i të dënuarit nuk është i domosdoshëm kur “ekstradimi është mohuar ose sidoqoftë nuk është i mundur”.

Ndonëse kjo dispozitë nuk ka lidhje me rastin në shqyrtim, zgjidhja që jepet për një situatë të ngjashme jep një argument më tepër në favor të përfundimeve të parashtruara më lart.

4. Për sa parashtrohet në analizat e mësipërme në tërësi Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se nuk vërehet ndonjë ndeshje (kolizion) midis dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale dhe dispozitave korresponduese të konventave ndërkombëtare, megjithëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë është miratuar e ka hyrë në fuqi më vonë se Kodi i Procedurës Penale dhe, gjithashtu, konventat europiane janë nënshkruar e ratifikuar më vonë.

Në parashtrimet dhe konkluzionet e mësipërme Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë janë unanime. Mendimet ndahen për zgjidhjen nëse Gjykata e Lartë mundet dhe duhet ta bëjë vetë njohjen e vendimit penal të huaj apo duhet ta dërgojë çështjen për rishqyrtim. Shumica është e mendimit se duhet të zbatohet opsioni i dytë për dy arsye:

1. Gjykata e Lartë nuk mund të zgjerojë juridiksionin e saj fillestar, veç rastit të parashikuar në nenin 141/1 të Kushtetutës.

2. Gjykata e Lartë, po të vendoste vetë, do të shkelte parimin e vendosur në nenin 43 të Kushtetutës, sipas të cilit “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

Vendimi i gjykatës së shkallës së parë për njohjen e një vendimi penal të një gjykate të huaj mund të ankimohet në rrugën e zakonshme të ankimit si të gjithë vendimet e tjera.

Ky vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë i jep zgjidhje të plotë e përfundimtare problemit që mosdhënia e pëlqimit për njohjen e vendimit prej personit të dënuar nga një gjykatë e huaj nuk është pengesë për gjykatën shqiptare për të proceduar për njohjen e këtij vendimi.

Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje avokatët kanë theksuar faktin që midis shtetit shqiptar dhe atij italian nuk është lidhur ndonjë marrëveshje dypalëshe për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve penale, prandaj, sipas tyre, njohja dhe ekzekutimi i një vendimi penal i një gjykate italiane do të cenonte sovranitetin e shtetit shqiptar, të cilin e ushtron vetëm Kuvendi i Shqipërisë, në rastin konkret nëpërmjet ratifikimit të një konvente ndërkombëtare ose marrëveshjeje dypalëshe. Ky pretendim është i gabuar. Parlamenti shqiptar e ka shprehur vullnetin e tij sovran nëpërmjet miratimit të Kodit të Procedurës Penale, dispozitat e të cilit, që kanë lidhje me këtë çështje, duhet të zbatohen sipas kuptimit që ato kanë dhe interpretimit të unifikuar të tyre prej Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të parashtruara më lart.

Duhet të theksojmë gjithashtu se në mungesë të instrumenteve juridike të nënshkruara e të ratifikuara, normat përgjithësisht të pranura të së drejtës ndërkombëtare mund të zbatohen edhe sipas parimit të vullnetit të mirë dhe të reciprocitetit. Marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja, ndër to edhe me ato italiane, Kodi i Procedurës Penale ia ka ngarkuar Ministrisë së Drejtësisë.

Sipas nenit 512 të Kodit të Procedurës Penale, nëse kjo ministri do të procedojë ose jo për të kërkuar në gjykatë, nëpërmjet prokurorisë, njohjen në Shqipëri të një vendimi penal që ndodhet në Shqipëri, kjo është në diskrecionin e plotë të saj si shprehje e një vullneti politik të shtetit shqiptar. Ky lloj diskrecioni nuk mund të vlerësohet gjyqësisht. Gjykata në këtë fazë ka të drejtë të vlerësojë vetëm nëse kërkesa është bërë nga organi kompetent sipas ligjit dhe nëse dokumentacioni është i plotë dhe të

kërkojë që ai të plotësohet sipas ligjit.

## PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 141/2 të Kushtetutës, në nenin 14 germa “c” të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” dhe në nenin 438 e 441 pika 1 germa “ç” të Kodit të Procedurës Penale,

## V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit nr.384, datë 24.7.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.555, datë 20.6.2002 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me çështjen penale Prokuroria e Përgjithshme, për njohje vendimi penal në ngarkim të shtetasit Arben Grori.

Kam mendimin se kërkesa e organit të prokurorisë është në kundërshtim me parimet themelore kushtetuese të një shteti dhe kryesisht me parimin e sovranitetit të shtetit.

Në bazë të nenit 2 të Kushtetutës, sovraniteti i takon popullit, i cili e ushtron këtë nëpërmjet përfaqësuesve të tij.

Në rastin që paraqitet, sovraniteti i shtetit tonë cenohet, pasi ai detyrohet të kryejë një veprim të cilin nuk ia ka autorizuar sovrani i tij dhe që cenon interesat dhe të drejtat e shtetasit të tij.

Po ashtu edhe e drejta ka sovranitetin e saj dhe ajo zbatohet në kufijtë e shtetit të saj. Asnjë organ i huaj, qoftë edhe i drejtësisë nuk mundet të veprojë në shtetin tonë, nëse nuk ka shfaqje të vullnetit nga organi përfaqësues, domethënë nëse nuk ka një marrëveshje ndërkombëtare, multi ose bilaterale.

Nëse interesat janë të tilla që duhet të kryhet një veprim, atëherë duhet të gjendet rruga e ligjshme për kryerjen e atij veprimi, pra qeveritë e të dy shteteve të lidhin marrëveshjet përkatëse, që t'i hapin rrugë realizimit të veprimtarisë së organeve të tjera.

Kjo praktikë është e njohur jo vetëm në shkallë botërore, por edhe në marrëdhëniet e shtetit tonë me vende të tjera. Si shembull për këtë marrim marrëveshjet e ndryshme të lidhura me shtetin grek.

Në rrethanat e mësipërme, çmuj se gjykimi i çështjes duhet të pushohet, përse kohë nuk ka marrëveshje dy ose shumëpalëshe.

Agron Lamaj

## MENDIMI I PAKICËS

Jemi dakord me mendimin e shumicës së anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, përse i takon trajtimit në parim të problemit që shtrohet për unifikim, në lidhje me njohjen e vendimeve penale të gjykatave të huaja, në Republikën e Shqipërisë, si dhe me përfundimet unifikuese (sentencat) që u arritën në këtë vendim.

Jemi dakord, gjithashtu, edhe për trajtimin që i bëhet, nga shumica, njohjes së vendimit penal të Gjykatës së Parë Penale të Apelit të Milanos (Itali), nr. 6/01 e nr. 39/00, datë 2.2.2001, në ngarkim të të dënuarit, shtetas shqiptar, Arben Grori.

Por, sikurse është shprehur edhe në fund të pjesës arsyetuese të këtij vendimi, ku thuhet se mendimet ndahen për zgjidhjen nëse Gjykata e Lartë mundet dhe duhet ta bëjë vetë njohjen e vendimit penal të huaj apo duhet ta dërgojë çështjen për rishqyrtim, nuk jemi dakord me zgjidhjen që i ka dhënë shumica këtij problemi, duke vendosur dërgimin e çështjes për rishqyrtim, Gjykatës së shkallës së Parë Tiranë, për arsyet e mëposhtme:

Shumica shprehet se Gjykata e Lartë nuk mund të zgjerojë juridiksionin e saj fillestar, veç rastit të parashikuar në nenin 141/1 të Kushtetutës, argument që, për mendimin tonë, nuk është bindës, pasi nuk gjen mbështetje në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe përmban një keqinterpretim të dispozitës së referuar të Kushtetutës, nga ana e vetë shumicës.

Nisur nga kjo e fundit, duhet thënë se në pikën 1 të nenit 141 të Kushtetutës ku përcaktohen rastet, në të cilat Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe rishikues, bëhet fjalë për rastet kur Gjykata e Lartë gjykon si gjykatë e shkallës së parë çështjen penale në tërësinë e saj. Në rastet e përcaktuara, saktësisht, në këtë dispozitë, Gjykata e Lartë gjykon themelin e çështjes penale, akuzën e cila përbën objektin e gjykimit të çështjes e ku bëhet fjalë për një kategori të kufizuar personalitetesh dhe funksionarësh të lartë sikurse janë: Presidenti i Republikës, Kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, deputetët, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë.

Kurse për themelin në rastin e çështjes, objekt shqyrtimi në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, janë shprehur instancat gjyqësore të Republikës Italiane, sikurse janë: Gjykata e Pestë Penale e Milanos, vendimi i së cilës është konfirmuar me vendimin nr. 6/01 dhe nr. 39/00 regj. përgj. të Apelit të Milanos dhe Gjykata e Kasacionit të Italisë.

Kështu që kërkuesit Arben Gori, megjithëse në mungesë, (me dëshirën e tij për t'iu shmangur drejtësisë), i janë krijuar të gjitha mundësitë ligjore për të ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes, mundësi, të cilën ai edhe e ka shfrytëzuar, efektivisht, nëpërmjet ankimit të vendimit të dënimit me burgim të përjetshëm, në ngarkim të tij, në instancat përkatëse gjyqësore të shtetit italian, gjersa vendimi mori formë të prerë dhe pas kësaj, organet e ngarkuara me ekzekutimin e tij të mund ta vinin atë në ekzekutim.

Mirëpo, ky vendim nuk u arrit që të vihet në ekzekutim në Itali, pasi kërkuesi ndodhej në Shqipëri dhe pikërisht kjo që edhe arsyeja, që, duke zbatuar kërkesat e ligjit, u kërkua njohja e këtij vendimi nga gjykata shqiptare.

Dihet se gjykimi i zhvilluar nga gjykatat shqiptare për njohjen e një vendimi penal të huaj nuk ka të bëjë me objektin e gjykimit që është zhvilluar nga gjykata e huaj, në kuptimin që nuk ka të bëjë me themelin e çështjes për të cilën i gjykuari është deklaruar fajtor dhe dënuar nga ajo gjykatë (gjykata e huaj). Kështu që edhe vendimi për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, kur plotësohen urdhërimet e dispozitave të neneve 512 e 514 të Kodit të Procedurës Penale, marrë nga gjykatat shqiptare nuk është vendim i ri, por ka karakterin e një vendimi deklarativ, në kuptimin që shprehet nëse e njeh ose jo vendimin penal të gjykatës së huaj.

Në rastin kur vendoset pozitivisht, domethënë në favor të kërkesës së prokurorit për njohjen e vendimit penal të huaj, mbaron faza e parë e këtij gjykimi. Në fazën e dytë, sipas urdhërimeve të dispozitës së nenit 516 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata cakton dënimin që duhet të vuajë i gjykuari në shtetin shqiptar, duke bërë konvertimin e dënimit të dhënë për të nga gjykata e huaj në një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar, dënim që, nga natyra e tij, duhet t'i përgjigjet atij që është dhënë në vendimin e huaj, me kusht që masa e dënimit të mos kalojë kufirin maksimal, të parashikuar për të njëjtin fakt, nga ligji shqiptar. Këto urdhërime, sikurse shihet nga natyra dhe përmbajtja e tyre, kanë karakter tekniko-ligjor, madje do të thoshim më tepër teknik, gjë që na bind ne për të mos u pajtuar me shumicën për mënyrën përfundimtare të zgjidhjes së çështjes në ngarkim të kërkuesit, duke e dërguar atë në gjykatën e shkallës së parë, në një kohë kur, përderisa u pranua se ekzistojnë kushtet e njohjes së vendimit penal të huaj, konvertimi i dënimit, sipas urdhërimeve të dispozitës së nenit 516 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pengesë ligjore që të bëhej nga vetë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përkundrazi, zgjidhja përfundimisht e çështjes nga këto kolegje do të evitonte zvarritjen e çështjes, pa cenuar të drejtat kushtetuese të kërkuesit, të cilat, sikurse u tha janë realizuar që në gjykimin në themel të çështjes në ngarkim të tij.

Vladimir Metani, Spiro Spiro

## V E N D I M

### Nr. 2, datë 29.1.2003

## NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Thimjo Kondi Kryetar  
Perikli Zaharia Anëtar  
Kristaq Ngjela Anëtar  
Spiro Spiro Anëtar  
Bashkim Caka Anëtar  
Metush Saraçi Anëtar  
Natasha Sheshi Anëtare  
Agron Lamaj Anëtar  
Artan Hoxha Anëtar  
Valentina Kondili Anëtare  
Vladimir Bineri Anëtar  
Ylvi Myrtja Anëtar  
Zamir Poda Anëtar  
Nikoleta Kita Anëtare  
Vladimir Metani Anëtar  
Irma Bala Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 29.1.2003 morën në shqyrtim çështjen penale nr.3/1, që i përket:  
TË PANDEHURVE: FOTAQ ZAHARIA, ELIDON LAZE, RIDVAN LERA,  
SAIMIR OSMANI

AKUZUAR: Për veprën penale të rrëmbimit e mbajtjes peng të personit me qëllim fitimi, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 109/2 e 25 të Kodit Penal dhe i pandehuri Elidon edhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.112, datë 21.5.2001 ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Fotaq Zaharia për veprën penale të parashikuar nga nenet 109/2 e 25 të Kodit Penal dhe e dënon atë me 25 vjet burgim. Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet zbritja e 1/3 së dënimit.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Elidon Laze për veprën penale të parashikuar nga nenet 109/2 e 25 të Kodi Penal dhe e dënon me 21 vjet burgim.

Deklarimin fajtor për armëmbajtje pa leje dhe në bazë të nenit 278/2 të Kodit Penal e dënon me 1 vit burgim.

Në bashkim të dënimeve e dënon me 21 vjet burgim.

Në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet ulja e 1/3 së dënimit.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Ridvan Lera për veprën penale të parashikuar nga nenet 109/2 e 25 të Kodit Penal dhe e dënon me 21 vjet burgim.

Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale urdhërohet ulja e 1/3 së dënimit.

Deklarimin fajtor të të pandehurit Saimir Osmani për veprën penale të parashikuar nga nenet 109/2 e 25 të Kodit Penal dhe e dënon me 15 vjet burgim.

Gjykata Apelit Vlorë, me vendimin nr.187, datë 24.7.2001 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.112, datë 21.5.2001 të Gjykatës së rrethit gjyqësor Vlorë për të pandehurin Fotaq Zaharia, Elidon Laze dhe Ridvan Lera.

Ndryshimin e këtij vendimi lidhur me të pandehurin Saimir Osmani dhe duke e gjykuar çështjen në fakt e ka deklaruar fajtor për veprën penale të përkrahjes së autorit të krimit, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal dhe e ka dënuar me 2 vjet e 7 muaj burgim.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit kanë bërë rekurs Prokurori Përgjithshëm dhe i gjykuari.

Prokurori parashtron këto shkaqe:

1. Në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë gjykimin e shkurtuar, si dhe me nenin 93 të këtij Kodi, është aplikuar gjykimi i shkurtuar dhe nuk është zbatuar vendimi i ndërmjetëm për veçimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit Saimir Osmani.

2. Nuk mund të zhvillohen së bashku edhe gjykimi i shkurtuar edhe gjykimi i zakonshëm.

3. Pranimi i gjykimit të shkurtuar në rastin konkret, është në kundërshtim me natyrën ligjore të

këtij gjykimi, i cili ka si qëllim të vetëm ekonominë gjyqësore dhe zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet, kurse në këtë çështje është pranuar kërkesa për gjykim të shkurtuar pas 30 seancash dhe pasi janë marrë gjithë provat nga të cilat fajësia e të pandehurve është e provuar plotësisht. Prandaj, vendimi i ndërmjetëm, që pranon gjykimin e shkurtuar duhet të prishet.

4. Ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës për të pandehurin Saimir Osmani, nga gjykata e apelit është i gabuar.

I gjykuari Fotaq Zaharia parashtroi këto shkaqe:

Gjykimi është bërë i njëanshëm, sepse janë marrë parasysh vetëm thëniet e të pandehurit Elidon Laze, që kanë shumë kontradikta të cilat gjykata nuk i analizoi. Në këto rrethana kërkohet ndryshimi i cilësimit ligjor të veprës nga rrëmbim personi, në moskallëzim krimi.

I pandehuri Elidon Laze parashtroi këto shkaqe:

Gjykatat nuk kanë marrë parasysh në dhënien e vendimit rrezikshmërinë më të ulët të tij, shkallën e fajit dhe rrethanat lehtësuese. Prandaj kërkon ndryshimin e vendimit përse i përket masës së dënimit me një masë më të butë.

I pandehuri Ridvan Lera parashtroi këto shkaqe:

Gjykatat kanë gabuar përse i përket cilësimit juridik të veprës dhe caktimit të masës së dënimit. Nuk është marrë parasysh personaliteti i mirë i tij, pendimi i thellë, implikimi rastësisht i tij në këtë krim, etj. Kërkon zbutjen e dënimit.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.87, datë 6.2.2002 ka vendosur:

Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për unifikimin e praktikës gjyqësore lidhur me aplikimin e gjykimit të shkurtuar.

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Artan Hoxha dhe Metush Saraçi, prokurorin pranë Gjykatës së Lartë Artan Bajrami, i cili kërkoi pranimin e rekursit, mbrojtësin e të gjykuarit Ridvan Lera, avokatin Virgjil Karaj, i cili kërkoi pranimin e rekursit paraqitur prej të gjykuarit dhe pasi biseduan çështjen në tërësi,

#### V Ë R E J N Ë:

Vendimet e të dy gjykatave janë marrë në aplikim të gabuar të ligjit e për këtë shkak janë të cenueshme.

Nga aktet e ndodhura në dosje rezulton se të gjykuarit Fotaq Zaharia, Elidon Laze, Ridvan Lera dhe Sajmir Osmani janë akuzuar për veprën penale të rrëmbimit dhe mbajtjes peng të një të mituri me qëllim fitimi, vepër penale e parashikuar nga nenet 109/2 e 25 të Kodit Penal, kurse i gjykuari Elidon Laze edhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në përfundim të gjykimit, pasi ka administruar provat në seancë gjyqësore, ka arritur në përfundimin se është e provuar akuza në ngarkim të të gjykuarve dhe i ka dënuar respektivisht të gjykuarit Fotaq Zaharia me 25 vjet burgim, Elidon Laze me 21 vjet burgim, Ridvan Lera me 21 vjet burgim, por ua ka ulur dënimin me 1/3 në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale. Po ashtu, ka deklaruar fajtor të gjykuarin Sajmir Osmani dhe e ka dënuar me 15 vjet burgim, për shkak se ai nuk ka kërkuar gjykim të shkurtuar, ky ka qenë edhe dënimi përfundimtar.

Mbi ankimin e të gjykuarve, por edhe të prokurorit, i cili e ka konsideruar të gabuar aplikimin e gjykimit të shkurtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.187, datë 24.7.2001, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për tre të gjykuarit e parë dhe ka ndryshuar atë për cilësimin juridik të veprës për të gjykuarin Sajmir Osmani, duke e deklaruar fajtor për veprën penale të përkrahjes së autorit të krimit, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal dhe e ka dënuar përfundimisht me 2 vjet e 7 muaj burgim.

Mbi rekursin e prokurorit dhe të gjykuarve kjo çështje ka ardhur për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë për shkaqe të paraqitura në pjesën hyrëse të këtij vendimi. Nisur nga fakti se për gjykimin e shkurtuar në praktikën tonë gjyqësore janë mbajtur qëndrime të ndryshme që kanë sjellë edhe vendime të gabuara, Kolegji Penal në mbështetje të nenit 141/2 të Kushtetutës dhe nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale, me vendimin nr.87, datë 6.2.2002 e ka kaluar në Kolegjet e

Bashkuara këtë çështje, për të njehsuar praktikën gjyqësore lidhur me:

1. Cilat janë kriteret nga të cilat duhet të udhëhiqen gjykatat për të vendosur pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar ?

2. A mundet që në të njëjtën çështje e cila u përket disa të pandehurve, për një apo për disa prej tyre të aplikohet gjykimi i shkurtuar dhe për të tjerat gjykimi i zakonshëm ?

3. Kur të pandehurit janë sjellë për t'u gjykuar për më shumë se një akuzë dhe gjykata, mbasi ka pranuar kërkesën e tyre për gjykim të shkurtuar, në vendimin përfundimtar, në zbatim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale ul dënimin me burgim me një të tretën, si duhet të veprojë?

4. A mund të revokohet vendimi i ndërmjetëm i gjykatës me të cilin është vendosur pranimi i kërkesës së të pandehurit ose përfaqësuesit të posaçëm të tij për gjykim të shkurtuar dhe nëse po, në cilat raste dhe cilat duhet të jenë kriteret nga të cilat duhet të niset gjykata për të vendosur revokimin e këtij vendimi?

5. A mund të shfuqizohet vendimi i ndërmjetëm i gjykatës së shkallës së parë me të cilën pranohet kërkesa për gjykim të shkurtuar nga gjykata e apelit, kur ndaj tij është paraqitur ankim bashkë me ankimin kundër vendimit përfundimtar ?

Nga shqyrtimi në tërësi i akteve të ndodhura në dosje dhe ashtu sikurse kanë pranuar të dyja gjykatat në vendimet e tyre, rezulton se të gjykuarit Fotaq Zaharia, Elidon Laze, Ridvan Lera, banorë të qytetit të Vlorës, shokë mes tyre, në datën 24.10.1999, rreth orës 18.00, në afërsi të njësisë tregtare të shtetasit Pajtim Xhelaj kanë rrëmbyer fëmijën e këtij të fundit, Denis Xhelaj, i moshës 6 vjeç, duke e futur në makinën e të gjykuarit Elidon Laze. Pasi i kanë mbuluar kokën me një xhup, ata janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe kanë qëndruar në kodrat e fshatit Kaninë ku me fëmijën ka ndenjur i gjykuari Ridvan Lera, ndërsa dy të tjerët janë kthyer në Vlorë. Pajtim Xhelaj ka konstatuar mungesën e fëmijes dhe është vënë në kërkim të tij, duke njoftuar të afërm e të njohur dhe pas disa orësh ai ka vënë në dijeni edhe policinë, organet e shtypit dhe prokurorinë. Ndër personave që ai u ka kërkuar ndihmë ka qenë dhe i gjykuari Fotaq Zaharia, me të cilin kishte njohje të mëparshme, por që në momentin kur ai e ka kërkuar, rreth orës 23 të datës 24.10.1999, nuk gjendej në shtëpi. Fëmija Denis Xhelaj nga kodrat pranë fshatit Kaninë, është çuar në banesën (ku nuk banonte njeri) e dajës së të gjykuarit Elidon Laze, në lagjen "Kushtrimi" të qytetit të Vlorës, me qëllim që, derisa të realizohej përfitimi nga rrëmbimi, të mbahej i fshehur.

Ka rezultuar e provuar se i gjykuari Elidon Laze, i diktuar nga i gjykuari Fotaq Zaharia, ka hartuar një letër, me të cilën i paraqiste kushte babait të fëmijës së rrëmbyer që në shkëmbim të djalit të tij, Pajtim Xhelaj duhet të paguante 18 millionë lekë. Kjo letër i dorëzohet dy ditë më vonë, më 26.10.1999, rreth orës 19.15 nga dëshmitarja Alketa Mustafaj, dëshmitarit Pajtim Xhelaj. Ndërkohë, këtij të fundit, në numrin e telefonit të vjehrrit të tij, nga të gjykuarit, i jepeshin porosi për dërgimin e parave, duke e kërcënuar se në të kundërt nuk do ta shihte më fëmijën. Dy prej këtyre bisedave janë regjistruar dhe kanë shërbyer si provë në gjykim.

Duke qenë se rrëmbimi i fëmijës Denis u bë një ngjarje publike në media dhe në opinion dhe për shkak se policia po intensifikonte kërkimin për gjetjen e tij, të gjykuarit kanë vendosur ta largojnë fëmijën nga rrethinat e Vlorës. Pasi e futën në bagazhin e një makine, e kanë çuar në qytetin e Fierit dhe kur nuk kanë gjetur një shok të të gjykuarit Fotaq, e kanë çuar në shtëpinë e të gjykuarit Sajmir Osmani. Dy të gjykuarit, Fotaq dhe Elidon, janë kthyer përsëri në Vlorë për të kontaktuar me familjen e fëmijës së rrëmbyer, kurse i gjykuari Ridvan ka qëndruar me fëmijën. Në datën 2.11.1999, rreth orës 4.00 të mëngjesit, dy të gjykuarit, Elidon Laze dhe Fotaq Zaharia i kanë telefonuar babait të të miturit nga një kabinë, por si rezultat i interceptimit telefonik nga policia, është bërë e mundur të identifikohet vendi se nga telefonohej dhe kështu është arritur të kapet në flagrancë i gjykuari Elidon Elezi, ndërsa i gjykuari tjetër Fotaq Zaharia ka mundur të largohet. I gjykuari Elidon Laze ka treguar lidhur me veprimtarinë kriminale, bashkëpunëtorët e tij, si dhe vendin ku mbahej fëmija dhe kështu është bërë e mundur që në mëngjesin e kësaj dite të kapet në flagrancë i gjykuari Ridvan Lera dhe Sajmir Osmani, në shtëpinë e këtij të fundit, si dhe të lirohej fëmija i rrëmbyer, Denis Xhelaj. Nga kontrolli që i është bërë banesës së Elidon Lazes në datën 2.11.1999, është gjetur një armë zjarri automatike model 56 në gjendje të mirë teknike e për këtë shkak është akuzuar dhe dënuar edhe për veprën penale të armëmbajtjes pa leje, parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Në këto kushte, drejt ka vepruar gjykata e shkallës së parë kur ka deklaruar fajtorë për akuzën e rrëmbimit të personit të gjithë të gjykuarit, ndërkohë gjykata e apelit ka gabuar lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës nga rrëmbim personi, në përkrahje të autorit të krimit, për të gjykuarin

Sajmir Osmani.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se veprimet e të gjykuarit Sajmir Osmani përbëjnë figurën e krimit të rrëmbimit të personit dhe jo atë të përkrahjes së autorit të krimit, parashikuar nga neni 302 i Kodit Penal. Sipas kësaj dispozite, përkrahja e autorit të krimit lidhet me veprime të kryera në favor të tij, pasi ai të ketë përfunduar veprën penale dhe të ketë arritur qëllimin kriminal. Nga ana objektive kryerja e kësaj vepre realizohet nëpërmjet furnizimit të autorit me ushqime apo me mjete të tjera, sigurim banese ose vend qëndrimi, me qëllim që personi që ka kryer një krim, t'i shpëtojë arrestimit apo kapjes së tij. Sikurse shihet, për të konsumuar këtë figurë vepre penale kërkohet që autorit të kryerjes së një krimi t'i jepet ndihmë, me qëllim që të pengohet kapja ose arrestimi i tij. Pra, veprimtaria kriminale e autorit të krimit që përkrahet ka mbaruar, kurse krimi i rrëmbimit, megjithëse është konsumuar që në momentin e rrëmbimit, pavarësisht nëse e sjell pasojën realizimin e fitimit, është një vepër në vazhdimësi. Me fjalë të tjera, veprimtaria kriminale, megjithëse e konsumuar që me heqjen e lirisë nëpërmjet rrëmbimit ose mbajtjes peng, vazhdon të jetë e tillë për të gjithë kohën sa vazhdon kjo gjendje. Bashkimi i të tjerëve në këtë situatë kriminale, sikurse është rasti, pavarësisht se nuk është marrë pjesë në momentin e rrëmbimit, e bën të gjykuarin Sajmir Osmani bashkautor në kryerjen e veprës.

Për të arritur në këtë përfundim, veç sa mësipër, Kolegjet e Bashkuara kanë parasysh faktin se neni 109 i Kodit Penal, parashikon kryerjen e krimit në dy forma, në atë të rrëmbimit të personit dhe në atë të mbajtjes peng të tij. Në rastin e parë, personi largohet nga vendi i tij me forcë dhe mbahet diku tjetër, derisa të arrihet qëllimi kriminal. Në rastin e dytë, personi izolohet dhe mbahet peng në ambientet ku ai është, derisa të realizohet qëllimi kriminal. Kur dikush tjetër do të ofrohej për të realizuar mbajtjen peng në vazhdimësi, edhe pse nuk ka marrë pjesë që në fillim të pengmarrjes, ai do të përgjigjet për të njëjtën figurë krimi dhe jo për përkrahje të autorit pas kryerjes së krimit. Mbajtja peng, megjithëse është konsumuar që me momentin e parë, vazhdon në gjendje latente, derisa të ketë përfunduar veprimtaria kriminale.

Ndodhur në këto kushte, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë të drejtë vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, e cila e ka deklaruar fajtor të gjykuarin Sajmir Osmani për veprën penale të rrëmbimit të kryer ndaj një të mituri në bashkëpunim me tre të gjykuarit e tjerë, po ashtu edhe masën e dënimit të caktuar për të nga ajo gjykatë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se të gjitha pretendimet e ngritura nga të gjykuarit lidhur me fajësinë e tyre dhe masat e dënimit, janë të pambështetura në ligj dhe aktet e administruara. Vepra penale është provuar plotësisht se është kryer nga të gjykuarit, rrezikshmëria shoqërore e saj dhe e autorëve është e lartë dhe se gjykata e shkallës së parë në raport me rolin e tyre në këtë veprimtari, si dhe qëndrimin që ata kanë mbajtur gjatë procedimit, ka individualizuar drejt masat e dënimit duke zbatuar kërkesat e neneve 48, 49 e 50 të Kodit Penal.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, gjejnë me vend rekursin e prokurorit lidhur me aplikimin e gabuar të nenit 403 e në vazhdim të Kodit të Procedurës Penale. Rezulton se të tre të gjykuarit, Fotaq Zaharia, Elidon Laze e Ridvan Lera përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor në bazë të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, kanë kërkuar që të procedohet me gjykim të shkurtuar, ndërsa i gjykuari Sajmir Osmani nuk e ka bërë një kërkesë të tillë. Gjatë kohës që procedohej me këtë çështje, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që rregullojnë gjykimin e shkurtuar dhe që kanë përcaktuar në mënyrë të shprehur se kur mund të paraqitet kërkesa për gjykim të shkurtuar nuk kishin pësuar ndryshimet që janë bërë me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002. Ndërkohë, sipas nenit 404 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi, atë në kohë, kërkesa e refuzuar mund të riparaqitej, derisa nuk ishin bërë konkluzionet përfundimtare të palëve. Kërkesa e refuzuar, pas 30 seancash gjyqësore dhe pasi janë marrë provat, është përsëritur dhe gjykata, në seancën e datës 9.5.2001 ka vendosur të procedohet me gjykim të shkurtuar, duke revokuar vendimin e mëparshëm të saj. Po në këtë seancë, bazuar në nenit 93 të Kodit të Procedurës Penale, ka veçuar çështjen për të gjykuarin Sajmir Osmani dhe i ka dhënë fund shqyrtimit gjyqësor. Më tej, me kërkesë të palëve, ka vendosur të procedojë me administrimin e akteve shpresore dhe administrimin e fashikullit të dosjes hetimore. Gjykata i ka ftuar palët që të vazhdojnë me diskutimet përfundimtare, por mbi kërkesën e prokurorit të seancës dhe mbrojtësve të të gjykuarve, është vendosur që të jepet kohë për përgatitje. Në datat 14 dhe 15.5.2001, gjykata, i ka dëgjuar ato dhe në datë 21.5.2001 ka shpallur vendimin përfundimtar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka gabuar në vazhdimin e gjyimit bashkërisht për katër të gjykuarit, kur me vendim

të ndërmjetëm ka pranuar veçimin e çështjes për njërin prej tyre. Vazhdimi i gjykimit me parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve, mosreagimi i mbrojtësve për këtë dhe ndjekja e procedurës së një gjykimi të zakonshëm dhe të pandarë për të gjithë të gjykuarit, e ka bërë pa vlerë vendimin e ndërmjetëm. Gjykata, edhe pse nuk e ka revokuar atë nga pikpamja formale, në fakt e ka bërë këtë duke e shqyrtuar çështjen në vazhdim e të pandarë për të katër të gjykuarit. Pra, gjykimi i çështjes është përfunduar nga e njëjta gjykatë edhe për të gjykuarin Sajmir Osmani, pavarësisht nga mosrevokimi formal i vendimit të veçimit të akteve për të.

Edhe pse neni 404 i Kodit të Procedurës Penale, në paragrafin e dytë, tashmë të shfuqizuar, parashikonte të drejtën për ta riparaqitur kërkesën e refuzuar përpara se palët të jepnin konkluzionet përfundimtare, nuk ka pasur për qëllim përzierjen e gjykimit të posaçëm (gjykimit të shkurtuar), me gjykimin e zakonshëm. Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, duhen parë të lidhura dhe në harmoni me njëra-tjetrën, me qëllim që të kuptohet thelbi dhe dallimi ndërmjet këtyre gjykimeve. Praktika dhe eksperiencia e vendeve të tjera, të cilat kanë njohur gjykimet e posaçme dhe efektet pozitive të tyre, ka bindur ligjvënësin shqiptar të pranojë gjykimin e drejtpërdrejtë dhe gjykimin e shkurtuar.

Gjykimi i shkurtuar ka vlerë për ekonomi gjyqësore, sepse thjeshton dhe shkurton procedurat, rrit shpejtësinë dhe efektivitetin e gjykimit dhe sjell si pasojë një përfitim për të pandehurin në uljen e 1/3 të masës së dënimit dhe mosaplikimin e dënimit me burgim të përjetshëm.

Është e rëndësishme të theksohet fakti që ky përfitim nuk duhet të shkojë në dëm të dhënies së drejtësisë. Për këtë qëllim, kërkesën e të pandehurit ose mbrojtësit të posaçëm të tij, gjykata e pranon vetëm atëherë kur ajo paraprakisht bindet se mund ta përfundojë çështjen në gjendjen që janë aktet, pa qenë nevoja për t'ia nënshtuar ato shqyrtimit gjyqësor. Jo pa qëllim, në nenin 403/2 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohet se kërkesa depozitohet të paktën tri ditë përpara datës të caktuar për seancë ose përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor, duke i dhënë kështu mundësi gjykatës që ajo të vlerësojë se si duhet të procedojë më tej në gjykimin e çështjes. Gjykimi i shkurtuar, si gjykim i posaçëm, në thelb të tij ka pranimin e akteve të grumbulluara gjatë fazës së hetimit paraprak dhe eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Ky gjykim eviton fazën e hetimit gjyqësor e për pasojë, edhe atëherë kur ligji e parashikonte të drejtën e riparaqitjes së kërkesës, në thelb ka pasur për qëllim që të procedohej me gjykim të posaçëm, duke prezumuar se gjykimi i zakonshëm për shkaqe të ndryshme nuk ishte bërë i mundur. Megjithatë, për të evituar këtë paqartësi apo ndoshta një kontradiktë të ligjit, ndërmjet asaj që kërkohej të arrihej dhe asaj që parashikonte neni 404/2 i Kodit të Procedurës Penale, me ligjin nr.8813, datë 13.6.2002, ky paragraf është shfuqizuar dhe përfundimisht është konsoliduar ligjërisht fakti se kërkesa për gjykimin e shkurtuar bëhet derisa të mos jetë filluar shqyrtimi gjyqësor dhe se nuk mund të riparaqitet më, kur ai ka filluar.

Bazuar sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke unifikuar praktikën gjyqësore arrijnë në përfundimin se kur shqyrtimi gjyqësor ka filluar me gjykim të zakonshëm, nuk mund të vazhdohet më tej me gjykim të shkurtuar.

Në gjykimin e kësaj çështjeje, kanë qenë katër të pandehur, prej të cilëve tre kanë kërkuar gjykim të shkurtuar, ndërsa i katërti ka kërkuar të vazhdojë me gjykim të zakonshëm. Gjykata ka vepruar drejt kur ka vendosur fillimisht mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, por ka gabuar kur, pasi ka zhvilluar gjithë hetimin gjyqësor dhe debatin mbi provat e administruara, ka pranuar gjykim të shkurtuar për të tre nga të pandehurit dhe të vazhdojë me gjykim të zakonshëm, për të gjykuarin Sajmir Osmani. Gjykata, në këtë rast, jo vetëm ka kuptuar gabim konceptin e gjykimit të posaçëm, duke e konsideruar atë vetëm si një përfitim për të pandehurin në uljen e masës së dënimit, por padrejtësisht ka pranuar dy lloj gjykimesh në të njëjtin procedim.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke unifikuar praktikën gjyqësore arrijnë në përfundimin se në një gjykim me disa të pandehur nuk mund të procedohet për disa me gjykim të posaçëm dhe për të tjerët me gjykim të zakonshëm.

Vetëm në rastin kur në kushtet e nenit 93 të Kodit të Procedurës Penale, vendoset ndarja e çështjes, mund të lejohet gjykimi i shkurtuar për të pandehurit që e kanë kërkuar një gjykim të tillë dhe çështja të veçohet për të pandehurit e tjerë që kërkojnë gjykimin e zakonshëm. Është konceptualisht e gabuar kur gjykimi i shkurtuar aplikohet vetëm si përfitim për të pandehurin, pavarësisht nga fakti se është proceduar me gjykimin të zakonshëm.

Duke marrë shkas nga praktika jo të njëjta gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me këtë vendim unifikues sqarojnë edhe disa momente të tjera, që lidhen me gjykimin e shkurtuar.

Këtij gjykimi në dallim nga gjykimi i zakonshëm i mungon faza e marrjes së provave dhe kërkesat lidhur me pavlefshmërinë e tyre.

Ligji parashikon që çështja zgjidhet në gjendjen që janë aktet, që nënkupton pranimin e tyre nga palët, ashtu sikurse janë. Është detyrim i gjykatës të vlerësojë nëse në atë gjendje që janë aktet mund të japë vendim pa cenuar drejtësinë dhe interesat e ligjshme të të pandehurit. Gjykimi vazhdon me paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare, të cilat i referohen akteve të pranuar nga palët, sikurse parashikojnë nenet 405/5 dhe 6 i Kodit të Procedurës Penale dhe gjykata jep vendim bazuar në to.

Në rast se palët kanë pretendime lidhur me pavlefshmërinë e akteve, qofshin pavlefshmëri absolute ose relative dhe kërkojnë konstatimin ose deklarimin e kësaj pavlefshmërie, gjykata duhet të revokojë vendimin për gjykim të shkurtuar dhe të urdhërojë vazhdimin e procedimit me gjykim të zakonshëm.

Kur ligji parashikon se gjykata vendos të procedojë me gjykim të shkurtuar në gjendjen që janë aktet, nënkupton se gjykata ka detyrimin që përpara se të marrë vendimin për pranimin e kërkesës, duhet të shqyrtojë me imtësi aktet dhe në qoftë se ajo konstaton paraprakisht pavlefshmëri të tyre dhe e vënë atë përpara pamundësisë për të dhënë një vendim të bazuar, ajo duhet të mos e pranojë që në fillim kërkesën për gjykim të shkurtuar.

Kur për një të pandehur ka më shumë se një akuzë mund të lejohet gjykimi i shkurtuar për një ose më shumë prej tyre, kur një gjë e tillë kërkohet me kushtin që çështja të ndahet dhe të gjykohej më vete, pa u dëmtuar procedimi për çështjet e tjera, sikurse parashikon neni 93 i Kodit të Procedurës Penale.

Në interpretim të pikës 6 të nenit 404 të Kodit të Procedurës Penale, konsensusi i prokurorit nuk është kusht i domosdoshëm që gjykata të pranojë kërkesën e të gjykuarit për të proceduar me gjykim të shkurtuar. Kjo justifikon edhe të drejtën që ka prokurori për të bërë ankim kundër vendimit të gjykatës për pranimin e gjykimit të shkurtuar, ankim që mund të paraqitet së bashku me ankimin kundër vendimit përfundimtar.

Lloji i gjykimit i ndjekur nga gjykata e shkallës së parë, pavarësisht nga vendimi i saj i ndërmjetëm lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar, është i rëndësishëm për qëndrimin që duhet të mbajë gjykata e apelit për ankimin e palëve të parashikuar nga neni 406/3 i Kodit të Procedurës Penale.

Me pranimin e kërkesës për të vazhduar me gjykim të shkurtuar, dosja e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore dhe shërben për t'u bazuar në parashtrimin e konkluzioneve përfundimtare të palëve dhe për dhënien e vendimit nga gjykata.

Lidhur me mënyrën e aplikimit të uljes së dënimit, duhet fillimisht të caktohet dënimi për veprën penale dhe më pas aplikohet zbritja e një të tretës së tij.

Kur i pandehuri deklarohet fajtor për disa vepra penale, duhet të caktohet fillimisht dënimi për çdo njëërën prej tyre dhe pasi aplikohet bashkimi i dënimeve sipas nenit 55 të Kodit Penal, bëhet zbritja nga dënimi i bashkuar me një të tretën.

Marrë për bazë sa u arsyetua më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, çmojnë se aplikimi i nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për të gjykuarit Fotaq Zaharia, Elidon Laze dhe Ridvan Lera është në kundërshtim me nenin 403, 404, 405 të Kodit të Procedurës Penale e për pasojë në këtë pjesë të tij, vendimi duhet ndryshuar. Aplikimi i gabuar i ligjit, padrejtësisht ka krijuar nonsensin që megjithëse roli i të gjykuarit Sajmir Osmani në këtë veprimtari kriminale, në raport me tre të gjykuarit e tjerë, të jetë me më pak rrezikshmëri shoqërore, ky i fundit duhej të vuante një dënim më të lartë ose të njëjtë me ta.

#### PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të nenit 141/2 të Kushtetutës, nenit 17/a të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” dhe nenit 441/d të Kodit të Procedurës Penale.

#### V E N D O S Ë N:

Prishjen e vendimit nr.187, datë 24.7.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.112, datë 21.5.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke e ndryshuar në pjesën që

bën fjalë për aplikimin e nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale dhe përfundimisht Fotaq Zaharia dënohet me 25 vjet burgim, Elidon Laze me 21 vjet burgim, Ridvan Lera me 21 vjet burgim dhe Sajmir Osmani me 15 vjet burgim.

Njoftohet prokurori pranë Gjykatës së Lartë për ekzekutimin e këtij vendimi.

Ky vendim për njehsimin e praktikës gjyqësore, dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

**V E N D I M**  
**Nr.3, datë 30.1.2003**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi Kryetar

Perikli Zaharia Anëtar

Kristaq Ngjela Anëtar

Spiro Spiro Anëtar

Bashkim Caka Anëtar

Agron Lamaj Anëtar

Artan Hoxha Anëtar

Natasha Sheshi Anëtare

Nikoleta Kita Anëtare

Ylvi Myrtja Anëtar

Valentina Kondili Anëtare

Vladimir Metani Anëtar

Vladimir Bineri Anëtar

Zamir Poda Anëtar

Irma Bala Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 30.01.2003 morën në shqyrtim çështjen civile me palë:

PADITËS: SELAMI ZALLI, përfaqësuar nga avokat Neshat Fana.

TË PADITUR: 1. PRESIDENTI I REPUBLIKËS Së SHQIPËRISË, në mungesë.

2. PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Kasem Berberi.

OBJEKTI: Shfuqizim i dekretit nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.97, datë 18.9.2002 ka vendosur:

Shfuqizimin e dekretit nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës “Për transferim dhe lirim prokurori” përsa i përket prokurorit Selami Zalli.

Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, duke parashtruar sa më poshtë:

- Vendimi është në kundërshtim me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

- Gjykata ka interpretuar gabim nenin 24 të këtij ligji. Marrja e mendimit të prokurorit nuk nënkupton marrjen e pëlqimit të tij për transferimin si në rastin e gjyqtarëve.

- Gjykata e apelit është kompetente të shqyrtojë masat disiplinore të dhëna nga Prokurori i Përgjithshëm sipas nenit 33 të ligjit “Për prokurorinë”, por ajo nuk është kompetente të shqyrtojë bazueshmërinë e dekretit të transferimit.

- Gjykata nuk mund të zgjerojë juridiksionin e saj tej atij të përcaktuar në ligj.

- Gjykata e apelit nuk ka pasur parasysh karakterin e centralizuar të funksionimit të prokurorisë.

- Vendimi i apelit krijon një precedent të dëmshëm për veprimtarinë normale të prokurorisë.

Me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore bazuar në nenin 481 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar me nenin 90 të ligjit nr.8812, datë 17.5.2001 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenin 14 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vendosur tërheqjen e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara, të cilat çmojnë të nevojshme të sqarohen e të njësohen qëndrimet për problemet e

mëposhtme:

- Cila është natyra juridike e dekreteve të Presidentit të Republikës? A mund të konsiderohen këto dekrete akte administrative në kuptim të nenit 106 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative dhe të neneve 324, 326 të Kodit të Procedurës Civile?

- Cila është natyra e marrëdhënies juridike që lind, ndryshon apo shuhet në rastin e emërimit, transferimit, ngritjes në detyrë, apo shkarkimit nga detyra të prokurorit?

- A legjitimohet prokurori të kundërshtojë në gjykatë dekretin e Presidentit të Republikës për emërimin, transferimin, ngritjen në detyrë, apo shkarkimin e tij nga detyra?

- Në rast të legjitimitetit të prokurorit si paditës, cili subjekt legjitimohet si i paditur: Presidenti i Republikës, Prokurori i Përgjithshëm, apo prokurori i prokurorisë pranë gjykatës përkatëse ku është prokurori paditës?

- Në rastin e pranimit të juridiksionit gjyqësor për shqyrtimin e ligjshmërisë së dekretit të Presidentit të Republikës, cilët janë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor? Do të shqyrtohet ligjshmëria e dekretit si i tillë, apo do të zgjidhen vetëm pasojat që rrjedhin nga dëmtimi i interesave ekonomiko – financiare të prokurorit përkatës të transferuar, apo larguar nga detyra?

### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Thimjo Kondi e Natasha Sheshi, përfaqësuesin e Prokurorit të Përgjithshëm, që kërkoi prishjen e vendimit të gjykatës së apelit, avokatin e paditësit, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit dhe pasi e biseduan çështjen në tërësi,

### V Ë R E J N Ë:

Vendimi nr.97, datë 18.9.2002 i Gjykatës së Apelit Tiranë është i pabazuar në ligj, prandaj duhet të priset dhe gjykimi i çështjes duhet të pushohet. Padia e paditësit Selami Zalli, me të cilën është kërkuar shfuqizimi i dekretit nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës, bazuar në nenin 324/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, është një padi që nuk mund të ngrihej.

Kjo dispozitë procedurale përcakton, ndër të tjera, kompetencën lëndore të seksioneve administrative të gjykatave për të shqyrtuar ligjshmërinë e akteve administrative. Por, para se të trajtohet problemi i kompetencës gjyqësore për shqyrtimin e një çështjeje, përfshi edhe kompetencën lëndore, duhet të përcaktohet në radhë të parë natyra juridike e aktit që kërkohet të kundërshtohet dhe juridiksioni për shqyrtimin e kushtetueshmërisë e ligjshmërisë së tij. Sipas nenit 24/1 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, “Ngritja në detyrë më të lartë ose transferimi mund të bëhet vetëm për nevoja dhe në interes të punës nga Presidenti i Republikës, me propozimin e Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prokurorit”. Gjersa vendimmarrja për raste të tilla i takon Presidentit të Republikës, sipas këtij ligji, në vështrim edhe të nenit 94 të Kushtetutës, dhe duke pasur parasysh se sipas nenit 93 të Kushtetutës, aktet që nxjerr Presidenti kanë formë juridike të dekretit, atëherë edhe ngritjet në detyrë ose transferimet e prokurorëve bëhen me dekrete të karakterit individual.

Atëherë shtrohet pyetja: Cila është natyra juridike e këtyre dekreteve individuale? A mund të klasifikohen ato si akte administrative në kuptim të nenit 106 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative dhe, për rrjedhojë, a mund të kundërshtohen si të tilla në gjykatë sipas procedurës së parashikuar në nenet 324 – 333 të Kodit të Procedurës Civile?

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se dekretet e Presidentit të Republikës janë akte të natyrës juridiko – kushtetuese dhe jo akte administrative, të përcaktuara si të tilla nga neni 106 i Kodit të Procedurave Administrative. Sipas kësaj dispozite, “Për qëllimet e këtij ligji, do të konsiderohen akte administrative të gjitha vendimet [lexo: urdhërimet] e organeve të administratës publike, të cilat krijojnë pasoja juridike në raste individuale”.

Dekretet e Presidentit të Republikës nuk mund të përfshihen në të njëjtën kategori me aktet e organeve të administratës publike. Ato janë akte të pushtetit të lartë ekzekutiv (të Kryetarit të Shtetit) me të cilat vendosen emërimet, shkarkimet, ngritjet në përgjegjësi, transferimet, gradimet, etj. të një kategorie funksionarësh të rëndësishëm të shtetit. Marrëdhëniet e këtyre personave me shtetin për kryerjen e detyrave të caktuara bazohen jo në një kontratë të thjeshtë pune, por në një kontratë të veçantë të shërbimit publik, nëpërmjet të cilës ata marrin përgjegjësi të veçantë për mbrojtjen e

interesave të larta publike, në të cilat mishërohet vetë sovraniteti i shtetit.

Si të tilla, ato bazohen jo vetëm në profesionalizmin, por edhe në një shkallë të lartë besimi dhe besnikërisë ndaj shtetit. Është kjo arsyeja që lidhja, ndryshimi apo mbarimi i kësaj kontrate shërbimi publik, nuk formalizohet me një akt të zakonshëm të një organi të administratës publike (akt administrativ), por me dekret të Presidentit të Republikës.

Nisur nga sa më lart, është në diskrecionin e shtetit, të mishëruar në dekretin e Presidentit jo vetëm krijimi, por edhe ndryshimi ose shuarja e marrëdhënieve të shërbimit publik të një karakteri të tillë. Në raste të tilla të largimeve nga puna apo transferimeve në kushte të disfavorshme, shteti merr përsipër vetëm që kësaj kategorie funksionarësh publikë t'u kompensojë një pjesë të humbjeve që u rezultojnë prej uljes së pagave, si dhe u garanton pensionet.

Në këtë kategori funksionarësh të rëndësishëm të shtetit janë përfshirë edhe prokurorët e të gjitha niveleve. Kjo rezulton prej neneve 148, 149 të Kushtetutës dhe dispozitave të ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë.

Ndërsa gjyqtarët e të gjitha niveleve gëzojnë një status të veçantë të rregulluar në Kushtetutë e në ligj, i cili garanton edhe patundshmërinë e tyre në detyrë, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, prokurorinë nuk e përfshin në sistemin gjyqësor dhe prokurorët nuk gëzojnë një mbrojtje juridike dhe garanci të një shkalle të njëjtë me ato të gjyqtarëve.

Për rrjedhojë, edhe prokurorët përfshihen në kategorinë e atyre funksionarëve të rëndësishëm të shtetit, qëndrimi i të cilëve në detyrën e caktuar bazohet në një vendimmarrje të karakterit diskrecional, që formalizohet me dekret të Presidentit të Republikës. Dekreti për transferimin pa afat të prokurorit në një detyrë tjetër më të lartë ose më të ulët, urdhëron ndryshimin në mënyrë të njëanshme të kontratës së shërbimit publik që shteti ka lidhur me të. Sipas nenit 24/1 të ligjit për prokurorinë kërkohet të jetë marrë paraprakisht mendimi i prokurorit, por marrja e mendimit nuk do të thotë dhënie e pëlqimit për transferimin si kusht pa të cilin transferimi nuk mund të bëhet.

Marrja e mendimit dhe jo dhënia e pëlqimit duhet të bëhet paraprakisht, sepse ky mendim mund të përmbajë në vetvete arsye të përligjura e bindëse, që do ta çonin Prokurorin e Përgjithshëm në përfundimin që propozimi për transferim nuk duhet bërë ose Presidentin e Republikës në përfundimin që transferimi i propozuar nuk duhet dekretuar. Megjithatë, kur, edhe pas marrjes së mendimit të prokurorit, propozimi për transferimin dhe dekretimi i tij realizohen, prokurori i transferuar nuk ka mundësi mbrojtjeje gjyqësore për të shfuqizuar dekretin e Presidentit të Republikës, që është akt individual i natyrës juridiko - kushtetuese, i nxjerrë nga Kryetari i Shtetit, në përmbushje të kompetencave të tij kushtetuese. Moszbatimi i dekretit të Presidentit për transferimin passjell zgjidhjen e detyruar të kontratës së shërbimit publik.

Kushtetuta nuk parashikon ndonjë mjet juridik për të kundërshtuar në ndonjë juridiksion të caktuar zgjidhjen e kësaj kontrate dhe për të rivendosur të gjitha të drejtat e humbura (restitutio in integrum).

Dekretet e Presidentit të Republikës të nxjerra në bazë të kompetencave të tij kushtetuese nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, sepse vetë Kushtetuta e ka përjashtuar një mundësi të tillë.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk mund të shprehen në mënyrë hipotetike nëse do të ishte në pajtim me Kushtetutën një ligj, i cili do të mundësonte kundërshtimin në gjykatë dhe anulimin prej saj të dekreteve të Presidentit të Republikës për transferimin e prokurorëve. Megjithatë, Kushtetuta edhe në raste të tjera kur një vendimmarrje e caktuar bëhet me dekret të Presidentit të Republikës nuk mundëson kundërshtimin e dekretit as në Gjykatën Kushtetuese, as në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. P.sh.: Sipas nenit 136, pika 4, të Kushtetutës “gjyqtarët e tjerë (të gjykatave të shkallës së parë e të apeleve) emërohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Por, Presidenti i Republikës as është i detyruar të arsyetojë refuzimin e tij për të dekretuar emërimin në detyrë të gjyqtarit të propozuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, as ekziston ndonjë mundësi kushtetuese apo ligjore për të kundërshtuar gjyqësisht mosnxjerrjen e dekretit, ashtu siç nuk mund të bëhet në asnjë rast edhe e kundërta, domethënë të atakohet në rrugë gjyqësore një dekret i nxjerrë brenda kompetencave kushtetuese të Presidentit të Republikës.

Prokurori i Përgjithshëm në rekurs shprehet se gjykata e apelit është kompetente të shqyrtojë masat disiplinore të dhëna ndaj prokurorëve nga Prokurori i Përgjithshëm sipas nenit 33 të ligjit “Për prokurorinë”, por ajo nuk është kompetente të shqyrtojë bazueshmërinë e dekretit të transferimit, sepse ajo nuk mund të zgjerojë juridiksionin e saj tej atij të përcaktuar në ligj. Pohimi i përgjithshëm se “gjykata e apelit nuk mund të zgjerojë juridiksionin e saj tej atij të përcaktuar në ligj”, është i drejtë në

vetvete, por ky pohim nuk është argument i përgjithshëm, i plotë për mungesën e juridiksionit gjyqësor për të shqyrtuar ligjshmërinë e dekretit të Presidentit dhe për mungesën e kompetencës gjyqësore për ta shfuqizuar atë.

Sipas një rregulli të përgjithshëm, gjykata nuk mund të tërhiqet nga shqyrtimi i një çështjeje që përmban pretendimin për shkeljen e një të drejte, në qoftë se ligji mungon. Atëherë, sipas këtij rregulli, nuk do të përjashtohet juridiksioni gjyqësor, dhe kompetenca lëndore e funksionale do t'i takonte gjykatës së shkallës së parë. Megjithatë, në këtë rast as gjykata e shkallës së parë nuk ka juridiksion.

Prokurori nuk legjitimohet të kundërshtojë në gjykatë dekretin e Presidentit të Republikës për emërimin, transferimin apo shkarkimin e tij jo për arsye se kjo nuk është parashikuar në mënyrë eksplicite në ligj, por për arsye se për dekretet e Presidentit, për shkak të natyrës së tyre juridike të përcaktuara nga Kushtetuta dhe për shkak të karakterit të posaçëm të kontratës së shërbimit publik për një kategori të caktuar funksionarësh të rëndësishëm të shtetit, siç janë edhe prokurorët, juridiksioni gjyqësor është përjashtuar.

Në aspektin procedural Prokurori nuk legjitimohet si paditës për të kundërshtuar në gjykatë dhe për të kërkuar shfuqizimin e dekretit të Presidentit të Republikës. Nga ana tjetër, edhe Presidenti nuk legjitimohet si i paditur.

Qëndrimi sipas arsyetimit të prezantuar më lart i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është në pajtim me precedentët e ngjashëm të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut të Strasburgut.

Në vendimin e saj, të datës 8.12.1999 në çështjen Pellegrin kundër Francës, kjo gjykatë, ndër të tjera, arsyeton si më poshtë: "...në sektorin publik të çdo vendi disa poste kanë të bëjnë me përgjegjësi, që janë në interesin e përgjithshëm ose me pjesëmarrje në ushtrimin e pushteteve që jepen prej të drejtës publike. Mbajtësit e posteve të tilla në këtë mënyrë përdorin një pjesë të pushtetit sovran të shtetit. Për rrjedhojë, shteti ka një interes legjitim për të kërkuar prej këtyre nëpunësve një detyrim të veçantë besimi dhe besnikërie. Nga ana tjetër, në lidhje me postet e tjera, të cilat nuk kanë këtë aspekt të "administrimit publik", nuk ka interes të tillë...."

Për rrjedhojë, gjykata vendos që të vetmet mosmarrëveshje që përjashtohen prej përmbajtjes së nenit 6/1 të Konventës [Europiane të të Drejtave të Njeriut] janë ato që ngrihen nga nëpunësit publikë, detyrat e të cilëve tipizojnë aktivitetet specifike të shërbimit publik për aq sa ky i fundit vepron si depozitar i autoritetit publik, që është përgjegjës për mbrojtjen e interesave të përgjithshme të shtetit ose të autoriteteve të tjera publike. Një shembull i shprehur qartë i aktiviteteve të tilla është rezervuar për forcat e armatosura dhe policinë...."

Rasti i mësipërm nuk i përmend në mënyrë të shprehur prokurorët. Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se sipas dispozitave të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ligjit "Për prokurorinë", edhe prokurorët duhet të përfshihen në një kategori të tillë të funksionarëve publikë. Ky përfundim rezulton nga karakteri i prokurorisë, si organ i centralizuar i shtetit, që vepron nën autoritetin, drejtimin, përgjegjësinë dhe kontrollin e Prokurorit të Përgjithshëm; nga roli i veçantë që Kushtetuta i jep Presidentit të Republikës në vendimmarrjet e rëndësishme që lidhen me statusin e prokurorit, si dhe nga përgjegjësia e lartë publike për të ushtruar ndjekjen penale dhe për të përfaqësuar akuzën në gjyq në emër të shtetit me objektivitet, ndershmëri, përkushtim dhe profesionalizëm të një shkalle të lartë. Domosdoshmëria për të rritur efikasitetin e luftës kundër kriminalitetit, në veçanti të atij të organizuar, i jep përparësi mbrojtjes së interesit publik, në krahasim me interesin e prokurorëve të veçantë për të ruajtur vendin e punës sipas kontratës së lidhur me shtetin për shërbimin e tyre publik.

Megjithatë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se, ndërsa përjashtohet juridiksioni gjyqësor për të shqyrtuar ligjshmërinë e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra ose transferimin e prokurorit, nuk përjashtohet tërësisht juridiksioni për të vendosur gjyqësisht zgjidhjen e disa pasojave që rrjedhin nga dëmtimi i interesave ekonomiko - financiare të prokurorit të transferuar ose të larguar nga detyra, kur këto masa nuk janë marrë si rezultat i shkeljeve disiplinore ose administrative, si dhe kur nuk janë për shkak të paafësisë profesionale në ushtrimin e detyrës.

Prokurorët në asnjë rast nuk mund të mbrohen në gjykatë me padi për rikthimin në detyrën që kishin. Megjithatë, duke i'u referuar për analogji edhe çështjes të Niegel kundër Francës, gjykuar nga Gjykata e Strasburgut me vendimin datë 17.11.1979, pranohet se paditë që lidhen me pagat ose

përfitimet e tjera financiare nuk janë të lidhura domosdoshmërisht me paditë për rikthimin në detyrë. Pagat, pensionet dhe përfitime të tjera, sipas kontratës së shërbimit publik, nuk janë të lidhura me ndonjë pushtet diskrecional. Diskrecioni mund të ushtrohet vetëm në lidhje me rekrutimin ose mbarimin e kontratave publike, por jo për rrjedhojat ekonomike që vijnë prej tyre.

Këto të drejta të karakterit privat (që nuk lidhen me të drejtën publike) mund të mbrohen në gjykatë si të gjitha të drejtat e tjera civile.

Duke qenë se në këto raste nuk është objekt shqyrtimi gjyqësor ligjshmëria e dekretit të Presidentit si të tillë, por vetëm pasojat që pretendohet se rrjedhin nga dëmtimi i interesave ekonomiko - financiare të prokurorit përkatës të transferuar ose të larguar nga detyra, në aspektin procedural nuk legjitimohet si i paditur Presidenti i Republikës, që ka nxjerrë dekretin, por Prokurori i Përgjithshëm, që konsiderohet si punëdhënës në kontratën e shërbimit publik.

Në një trajtim më të përgjithshëm, si i paditur në çdo rast legjitimohet punëdhënësi, domethënë institucioni me buxhetin e të cilit do të kompensohet eventalisht dëmi që i është shkaktuar paditësit.

#### PËR KËTO ARSYE:

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141 të Kushtetutës, të nenit 485 pika “e” të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të neneve 14 pika “c” dhe 17 pika “a” të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

#### V E N D O S Ë N:

1. Prishjen e vendimit nr.97, datë 18.9.2002 të Gjykatës së Apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.
2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

#### MENDIMI I PAKICËS

Në vitin 1993 paditësi Selami Zalli ka filluar punë në prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Me vendimin nr.4, datë 1.7.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ai është emëruar prokuror në Drejtorinë e Hetimit e të Kontrollit në Prokurorinë e Përgjithshme. Këtë detyrë ai e ka vazhduar për gjashtë vjet me radhë deri në muajin qershor të vitit 2001.

Në vitin 2001 Prokurori i Përgjithshëm i ka propozuar Presidentit të Republikës transferimin e paditësit në prokurorinë rrethit gjyqësor Pogradec. Ky propozim i është kthyer Prokurorit të Përgjithshëm me arsyetimin se nuk i është marrë mendimi prokurorit që do të transferohet dhe se propozimi më parë duhej të shqyrtohej në Këshillin e Prokurorisë.

Kur i është kërkuar mendim paditësit, ky i fundit e ka refuzuar transferimin me pretendimin se propozimi është në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” Refuzimin paditësi e ka bërë me shkrim dhe ia ka drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm. Në shkresë thuhet: “...ligji dhe dispozita konkrete të tij kanë karakter pozitiv dhe bëjnë fjalë për rastet e transferimit në të njëjtin nivel, detyrë ose ngritje në detyrë. Propozimi bën fjalë për të kundërtën e kërkesave të ligjit, pasi propozohet për t’u ulur në detyrë disa shkallë, duke pësuar rënie drastike në pagë dhe për t’u transferuar në një rreth larg qendrës së banimit. Ky veprim merr karakterin e një mase disiplinore, por në rastin konkret pa asnjë shkak ligjor...”.

Propozimi i Prokurorit të Përgjithshëm është shqyrtuar në mbledhjen e Këshillit të Prokurorisë, më datën 24.5.2001. Me shumicë votash Këshilli i Prokurorisë ka dhënë mendimin se transferimi i prokurorit Selami Zalli është i ligjshëm. Shumica e anëtarëve të Këshillit të Prokurorisë nuk kanë dhënë argumente për mënyrën e votimit, ndërsa pakica ka argumentuar :

“Propozimi për transferimin e prokurorëve nga prokuror pranë Gjykatës së Lartë, në prokuror pranë gjykatës së shkallës së parë, në bazë të nenit 24 të ligjit “Për Prokurorinë e Republikës”, është në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji, për këto arsye:

1. Nuk është transferim sipas ligjit “Për Prokurorinë e Republikës”, sepse që të quhet dhe të vlerësohet transferim në kuptimin e ligjit duhet të ruhen këto parametra:
  - a. të transferohet në të njëjtën detyrë (nivel prokurorie) ;

b. të ketë të njëjtën pagë ;  
të mos largohet nga vendbanimi.

Po u cenuan këto kritere nuk mund të quhet më transferim, por masë disiplinore.

2. Vetë neni 24 i ligjit “Për Prokurorinë e Republikës” për këto raste kërkon mendimin e prokurorit që transferohet. Fjala mendim është e njëjtë me fjalën pëlqim, kjo dhe në analogji me ligjin “Për organizimin e sistemit gjyqësor” ku në transferimin e gjyqtarëve kërkohej pëlqimi i tyre.

3. Këta prokurorë transferohen nga prokurorë të nivelit të lartë (prokuror pranë Gjykatës së Lartë) në prokuror pranë gjykatës së shkallës së parë, pra ulen në detyrë.

4. Paga e tyre nga 96 000 lekë që kanë bie në 39 000, pra rreth 60% ulje page.

5. Vetë paragrafi i dytë i nenit 24 të ligjit “Për Prokurorinë e Republikës” e zgjidh problemin kur prokurorët nuk japin pëlqimin për këtë lloj transferimi duke iu referuar nenit 33 të ligjit “Për prokurorinë”.

Pakica e Këshillit të Prokurorisë me këtë mendim kundra, mendon se shumica e Këshillit ka arritur në konkluzione të gabuara e në kundërshtim me ligjin dhe duke vepruar në këtë mënyrë mund të hapen precedent me pasoja në organizimin e Prokurorisë së Republikës.

Përpara se të dilte dekreti për transferimin e tij, paditësi i është drejtuar me një letër Presidentit të Republikës, me anën e së cilës i bënte të ditur se propozimi për transferimin e tij ishte në kundërshtim me ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

Mbi propozimin e dytë të Prokurorit të Përgjithshëm, Presidenti i Republikës ka nxjerrë dekretin nr.3037, datë 1.6.2001 me titull “Për transferim dhe lirim prokurori”, me anë të të cilit paditësi Selami Zalli është transferuar në detyrën e prokurorit në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec.

Dekretin në fjalë paditësi e ka kundërshtuar në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.29, datë 21.2.2002 ka vendosur: “Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare” me arsyetimin: “sipas nenit 131 shkronja “f” të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, Gjykata Kushtetuese shqyrton ankesat e individëve për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave”.

Pas përgjigjes së Gjykatës Kushtetuese, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në kërkesëpadi argumentohet :

- Transferimi është i kundërligjshëm pasi bie ndesh me ligjin nr.8737, datë 12.2.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”.

- Në nenin 24 të këtij ligji parashikohet ngritja në detyrë dhe transferimi i prokurorit në një detyrë më të lartë për nevoja dhe në interes të punës vetëm pasi të jetë marrë mendimi i prokurorit.

- Kur më është kërkuar mendim për këtë transferim, kam dokumentuar me shkrim mendimin kundër këtij propozimi me arsyetimin se transferimi nuk mund të bëhet për ulje në detyrë, por vetëm për lëvizje paralele ose ngritje në detyrë.

- Ulja në detyrë mund të bëhet vetëm si masë disiplinore dhe kjo për një periudhë nga 6 muaj deri në 1 vit (neni 33/1, c).

- Transferimi pa pëlqim është komandim. Komandimi parashikohet nga neni 25 i ligjit “Për prokurorinë”. Edhe lëvizja me komandim ka një afat të përcaktuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.100 akti, datë 15.4.2002 ka vendosur: “T’i kalojë padinë dhe aktet për kompetencë Gjykatës së Apelit Tiranë” me arsyetimin: “...duke u mbështetur në arsyetimin e vendimit nr.25, datë 13.2.2002 të Gjykatës Kushtetuese sipas të cilit dekreti i Presidentit konkludohet si i atakueshëm pa u përcaktuar gjykata kompetente në shqyrtimin e një mosmarrëveshjeje të tillë, si dhe duke parë nenin 34/1 të ligjit “Për prokurorinë”, i cili parashikon që për masat fillestare disiplinore i interesuari ka të drejtën e ankimit në gjykatën e apelit, pavarësisht se vendimi i transferimit në vetvete nuk përbën masë disiplinore (direkt), ai për paditësin ka sjellë pasojat e një mase të tillë. Sa më sipër, konkludoj se kompetente në shqyrtimin e kësaj çështjeje është Gjykata e Apelit Tiranë”.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.97, datë 18.9.2002 ka vendosur: “Pranimin e kërkesëpadisë. Shfuqizimin e dekretit nr.3037, datë 1.6.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë “Për transferim dhe lirim prokurori” përsa i përket paditësit Selami Zalli” me këtë arsyetim:

- Transferimi në vetvete ka sjellë si pasojë ndryshimin e vendit të punës, uljen e pagës, etj, pasoja këto, që në fakt kanë cenuar marrëdhënien juridike të punës.

- Ligjvënësi, ngritjen në detyrë e ka barazuar me transferimin dhe në të dyja rastet realizimi i

tij bëhet me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi më parë të jetë marrë mendimi i prokurorit.

- Pa miratimin, domethënë pëlqimin e prokurorit, nuk mund të bëhet as ngritja në detyrë dhe as transferimi.

- Pëlqimi i prokurorit është element i domosdoshëm, pa të cilin nuk mund të realizohet as ngritja në detyrë e as transferimi.

- Ngritja në detyrë dhe transferimi pa pëlqimin e prokurorit cenon marrëdhënien juridike të punës dhe elementet thelbësore të saj, siç janë paga, vendi i punës etj.

- Ligjvënësi në mënyrë absolute ndalon ngritjen në detyrë dhe transferimin pa pëlqimin e prokurorit, ndryshe do të parashikonte zgjidhjen e këtij konflikti në gjykatë, siç ka parashikuar rastet e tjera.

- Ndonëse transferimi nuk është marrë si masë disiplinore, ai cenon marrëdhënien juridike të punës, elemente të veçanta të saj dhe paditësi mund të realizojë mbrojtjen, duke u mbështetur në nenin 34 të ligjit nr.8737, datë 12.2.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs Prokurori i Përgjithshëm, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë duke parashtruar:

- Vendimi i gjykatës së apelit është i padrejtë, teorikisht i gabuar dhe praktikisht dëmton veprimtarinë normale të prokurorisë në tërësi.

- Nga gjykata e apelit është interpretuar gabim neni 24 i ligjit "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

- Ndaj paditësit nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Gjykata e apelit padrejtësisht e ka bërë veten kompetente për shqyrtimin e këtij konflikti. Ajo gjykatë ka zgjeruar juridiksionin gjyqësor jashtë kuadrit të atyre rasteve që përcakton ligji.

- Gjykata e apelit me qëndrimin e saj ka marrë në mbrojtje të drejtat e prokurorit si "punëmarrës" dhe nga ana tjetër ka lënë pa mbrojtje të veçantë interesat në tërësi të organit të prokurorisë si "punëdhënës".

Për të njëzuar praktikën gjyqësore çështja është dërguar për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Përpara Kolegjeve të Bashkuara është shtruar për zgjidhje: Natyra juridike e dekreteve të Presidentit të Republikës, a mund të konsiderohen këto dekrete akte administrative, cila është natyra e marrëdhënies juridike që lind në rastin e transferimit të prokurorit, a legjitimohet prokurori të kundërshtojë në gjykatë dekretin e Presidentit të Republikës, cili subjekt legjitimohet si i paditur, cilët janë kufijtë e shqyrtimit gjyqësor do të shqyrtohet ligjshmëria e dekretit apo zgjidhja e pasojave?

Në përfundim të gjykimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë vendosur: "Prishjen e vendimit nr.97, datë 18.9.2002 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes" me arsyetimin se padia objekt gjykimi nuk mund të ngrihet dhe se dekretet e Presidentit të Republikës nuk i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor. Kushtetuta e Shqipërisë nuk mundëson kundërshtimin e dekretit të Presidentit të Republikës as në Gjykatën Kushtetuese, as në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

Ne gjyqtarët në pakicë nuk pajtohemi me zgjidhjen që i kanë dhënë çështjes Kolegjet e Bashkuara për këto arsye:

Padia objekt gjykimi mund të ngrihet. Me padinë objekt gjykimi kërkohet shfuqizimi i një akti administrativ. Paditësi ka pretenduar se akti administrativ objekt kundërshtimi është i paligjshëm dhe se atij i cenohen interesat dhe të drejtat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë. Sipas paditësit janë cenuar të drejtat e sanksionuara në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë" dhe konkretisht kërkesat e nenit 24 të këtij ligji. Pretendimi kryesor i paditësit është se me aktin administrativ objekt gjykimi është ndryshuar në mënyrë të njëanshme "kontrata juridike e punës". Përveç ligjit material të cituar, më sipër padia e paditësit është bazuar edhe në nenin 324 e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkesëpadia e paditësit është pranuar nga Gjykata e Apelit Tiranë me arsyetimin që kemi dhënë më sipër, por ky vendim është prishur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe çështja është pushuar me arsyetimin se kjo padi nuk mund të ngrihej.

Marrëdhëniet procedurale civile, që rregullohen nga Kodi i Procedurës Civile janë të lidhura e të ndërvarura me marrëdhëniet materiale – juridike përkatëse. Që në fazën fillestare kur është investuar Gjykata Kushtetuese dhe gjykata e rrethit, është sqaruar natyra dhe lloji i marrëdhënies juridike. Marrëdhënia e paditësit me shtetin bazohet jo në një kontratë të thjeshtë pune, por në një kontratë të veçantë të shërbimit publik që rregullohet nga ligji "Për prokurorinë".

Paditësi ka qenë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme. Me dekretin objekt gjykimi është transferuar në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. Transferimi i bërë me dekretin e mësipërm, kundërshtohet nga paditësi se vjen në kundërshtim me ligjin “Për prokurorinë”. Në këtë kuadër gjykata ka qenë e detyruar të vendosë vetëm për atë që është kërkuar dhe se vendimi i saj duhej të shtrihej vetëm brenda kufijve të kërkesës.

Nga asnjë material i administruar në dosje dhe nga asnjë dispozitë ligjore materiale e procedurale nuk thuhet se kjo padi nuk mund të ngrihet, përkundrazi, në nenin 34 të ligjit “Për prokurorinë” thuhet shprehimisht: Kundër dhënies së masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c” të pikës 1 të nenit 33, mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Edhe në Kodin e Procedurës Civile parashikohet padia, me të cilën kërkohet shfuqizimi i një akti administrativ (neni 324 e vijues të Kodit të Procedurës Penale).

Dekreti i Presidentit nr.3037, datë 1.6.2001 për transferimin e paditësit është akt administrativ. Në këtë përfundim ka arritur Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.25, datë 13.2.2002. Në këtë vendim thuhet “... Presidenti i Republikës, në ushtrimin e funksioneve të tij, krahas akteve që janë rezultat dhe shprehje e drejtimit politik, nxjerr akte individuale me karakter administrativ. Në aktet me karakter administrativ, përfshihen dhe dekretet që dalin në adresë të prokurorëve”.

Ndërmjet palëve ndërgjygjëse ka ekzistuar dhe vazhdon të ekzistojë një kontratë e veçantë e shërbimit publik. Kontrata e parë nuk është zgjidhur, paditësi nuk është larguar nga organi i prokurorisë; ai vazhdon të punojë si prokuror, por jo në Prokurorinë e Përgjithshme, por në prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec. Ai është dërguar atje në mënyrë të njëanshme nga “punëdhënësi” pa pëlqimin e tij, me dekretin objekt gjykimi. Paditësi e ka zbatuar urdhrin e transferimit, duke shkuar në vendin e ri të punës, por njëkohësisht e ka kundërshtuar në rrugë gjyqësore këtë transferim”. Ai pretendon se transferimi vjen në kundërshtim me nenin 24 të ligjit “Për prokurorinë ».

Neni në fjalë emërtohet: “Ngritja në detyrë dhe transferimi”. Në këtë nen thuhet: “1. Ngritja në një detyrë më të lartë ose transferimi mund të bëhet vetëm për nevoja dhe në interes të punës nga Presidenti i Republikës, me propozim të Prokurorit të Përgjithshëm, pasi të jetë marrë mendimi i prokurorit. 2. Bëjnë përjashtim nga parashikimet e pikës 1 të këtij neni rastet e parashikuara nga nenet 25 dhe 33 të këtij ligji”.

Kjo dispozitë e ligjit “Për prokurorinë” është interpretuar drejt nga gjykata e apelit. E drejta e sanksionuar në nenin 24 të ligjit “Për prokurorinë” është mohuar dhe shkelur njëkohësisht nga “punëdhënësi”. Në bazë të kësaj dispozite, transferimi mund të quhet i ligjshëm dhe të realizohet, në qoftë se bëhet:

1. Për ngritjen në detyrë.
2. Për t’u dërguar në një prokurori të të njëjtit nivel.
3. Për nevoja dhe në interes të punës.
4. Pasi të jetë marrë mendimi i prokurorit.

Në transferimin objekt gjykimi nuk është përmbushur asnjëra prej kushteve që kërkon neni 24 i ligjit. Për pasojë, transferimi që i është bërë paditësit Selami Zalli vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 24 të ligjit “Për prokurorinë”. Shumica arsyeton vetëm njërin nga elementet. Në nenin 24 është përcaktuar në mënyrën më të saktë se transferimi duhet të jetë i motivuar, se bëhet për nevoja dhe në interes të punës. Nga dekreti dhe aktet e tjera të administruara në dosje, nuk del qëllimi, ose më mirë të themi arsyeja se pse duhej bërë ky transferim. Në rastin konkret, në fakt kemi të bëjmë me një ndëshkim të paligjshëm.

Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë”, përveç transferimit të parashikuar nga neni 24, ka sanksionuar transferimin për shkelje të disiplinës në punë (neni 33/1 – c) dhe transferimin pa pëlqim (neni 25) të titulluar komandim. Transferimi që i është bërë paditësit është më i rëndë, se transferimi për shkelje të disiplinës dhe transferimi pa pëlqim (komandim), të cilat mund të vazhdojnë gjashtë muaj deri në një vit. Paditësi ka plot 22 muaj i transferuar. Të ndëshkuarit për shkelje të disiplinës në punë, mund të kthehen në punën e mëparëshme, ndërsa paditësi jo. De facto, transferimi i paditësit është “largim nga puna pa të drejtë ankimi”. Kjo procedurë lë vend për abuzime për të larguar këdo për shkaqe subjektive. Vërtet prokurorët nuk bëjnë pjesë në ndonjë pushtet, por ata janë punonjës publikë. Punonjësit publikë mbrohen nga ligji “Për shërbimin civil”, ndërsa prokurorët nga ligji “Për prokurorinë”.

Përveç ligjit “Për prokurorinë”, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e parashikon në mënyrë

të shprehur rivendosjen e të drejtave ligjore të cenuara. Sipas Kushtetutës “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe të interesave të tij të ligjshme ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik”, brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj (neni 42).

Pakica ka mendimin se dekretet individuale të Presidentit të Republikës i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor kur ligji e parashikon. Këto akte individuale mund të kundërshtohen në gjykatë dhe është në kompetencë të gjykatës shqyrtimi i ligjshmërisë së tyre, e për rrjedhojë dhe shfuqizimi, kur janë të kundraligjshme. Mendimi ynë është se këto akte i nënshtrohen kontrollit të gjykatave të zakonshme. Edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.25, datë 13.2.2002 thuhet në mënyrë të shprehur: “Dekretet individuale duhet të jenë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor”.

Shqyrtimi i ligjshmërisë së dekretëve individuale që lidhen me prokurorët hyn në juridiksionin gjyqësor për këto arsye: së pari parashikohet shprehimisht në ligjin “Për prokurorinë” (neni 34 i ligjit “Për prokurorinë”); së dyti kushdo mund t’i drejtohet gjykatës për rivendosjen e të drejtave të cenuara (neni 42 i Kushtetutës); së treti nuk mund të refuzohet shqyrtimi i një çështjeje me arsyetimin se ligji mungon, nuk është i plotë, ka kundërthënie ose është i paqartë (neni 1/II i Kodit të Procedurës Civile); së katërti parashikohet shprehimisht në Kodin e Procedurës Civile (neni 324 e vijues); së pesti dekretet e Presidentit në adresë të prokurorëve nuk përfshihen në ato akte administrative që përmenden në nenin 326 të Kodit të Procedurës Civile, për të cilat nuk mund të ngrihen padi në gjykatë; së gjashti Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.25 datë, 13.2.2002 ka vendosur se dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të prokurorit është i ankimueshem.

Interpretimi që bëjnë Kolegjet e Bashkuara vjen në kundërshtim me kriteret e mësipërme dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 132/1 të Kushtetutës vendimi i Gjykatës Kushtetuese ka fuqi detyruese të përgjithshme (erga omnes). Në kuadrin kushtetues, ai, domethënë vendimi i Gjykatës Kushtetuese është detyrues për të gjitha rrethet gjyqësore deri në Gjykatën e Lartë.

Gjykata e apelit është gjykatë kompetente. Kjo del nga neni 34 i ligjit “Për prokurorinë”, të cilin e kemi cituar më sipër.

Palët ndërgjygjëse kanë legjitimitet. Kërkimi i paditësit për njohjen e rivendosjen e të drejtës së shkelur justifikohet ligjërisht (neni 32 i Kodit të Procedurës Civile.). Sipas ligjit “Për prokurorinë” transferimi mund të bëhet kur plotësohen kushtet që kërkon neni 24. Në çështjen objekt gjykimi nuk vihet në diskutim legjitimiteti i palëve. Kërkimet e paditësit kanë një bazë ligjore (pra një interes të ligjshëm). Provohet se ndërmjet palëve ndërgjygjëse ka ekzistuar një kontratë. Kjo kontratë rregullohet nga ligji “Për prokurorinë”. Në nenin 34 të ligjit “Për prokurorinë” është parashikuar në mënyrë eksplicite se kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes është Gjykata e Apelit Tiranë.

Ligjvënësi ka kodifikuar procedurën gjyqësore të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve administrative, e cila rregullohet me një kapitull të veçantë të Kodit të Procedurës Civile të titulluar “Gjykimi i mosmarrëveshjes administrative”.

Pakica ka mendimin se Kolegjet e Bashkuara duke i’u referuar jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut kanë keqinterpretuar qëllimin dhe arsyetimin e kësaj gjykate në çështjen Pelegrini kundër Francës. Gjykata e Strasburgut në vendimin e saj shprehet për garantimin e të drejtave minimum dhe jo për zgjedhjet e brendshme ligjore të vendeve anëtare të Konventës për të Drejtat e Njeriut. Nëse një vend anëtar, pranon në legjisllacionin e tij të japë më shumë të drejta dhe garanci ligjore për statusin e prokurorëve, kjo nuk do interpretuar se bie ndesh me ndonjë parim të Konventës apo vendimin e Gjykatës së Strasburgut. Është në vlerësim të ligjvënësit që të përcaktojë sasinë dhe nivelin e garancive për funksionarët e tij, me kusht që të ruajë atë minimum të përcaktuar në konventë.

Në lidhje me sa u tha më sipër vlen të theksohet se, në dosjen gjyqësore është administruar një draft rekomandues me nr.99 “Mbi rolin e prokurorisë në sistemin e drejtësisë penale” hartuar nga komiteti i ekspertëve mbi rolin e prokurorisë në sistemin e drejtësisë penale të Komitetit Europian për problemet e krimit (tekst i rishikuar nga palët pjesëmarrëse në takimin e mbajtur në Strasburg nga 28 deri më 29 nëntor 1999). Në këtë material thuhet se shtetet duhet të marrin masa për të siguruar që:

- Rekrutimi, promovimi dhe transferimi i prokurorëve është realizuar sipas procedurave të drejta dhe të paanshme (4/a).

- Lëvizja e prokurorëve do të udhëhiqet nga nevojat e shërbimit. (4/c)

- Procedimet disiplinore kundër prokurorëve duhet të vendosen me ligj dhe duhet të garantohet një vlerësim i drejtë dhe efektiv dhe një vendim i cili duhet të jetë subjekt i rishikimit gjyqësor (4/e).

- Veprimtaria e prokurorëve duhet të jetë subjekt i rishikimeve të brendshme të rregullta (4/f).
- Prokurorët kanë të drejtën e procedurave të ankimit, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, paraqitjen në gjykatë atëherë kur statusi i tyre ligjor është prekur (4/g).

Nuk vihet në dyshim se transferimi i paditësit nga Prokuroria e Përgjithshme në Prokurorinë e Pogradecit është dhe duhet të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor, se është prekur statusi që parashikon vetë ligji “Për prokurorinë”.

Është e papranueshme për pakicën që prokurorët të lihen pa mbrojtje. Në traditën tonë kushtetuese dhe ligjore prokurorët deri përpara ndryshimeve me Kushtetutën e vitit 1998, kanë qenë pjesë e sistemit gjyqësor dhe për këtë shkak ata përfitonin të gjitha të drejtat dhe garancitë në detyrë të gjyqtarit. Pas miratimit të Kushtetutes se re prokurorët nuk gëzojnë të drejtat dhe garancitë që gëzojnë gjyqtarët, por nuk janë lënë pa të drejta dhe garanci. Në një shoqëri në tranzicion dhe të pastabilizuar, të lësh pa mbrojtje dhe garanci në detyrë prokurorin, na duket tepër e avancuar dhe e dëmshme për veprimtarinë e vetë organit të akuzës. Mendojmë se drejt ka vlerësuar ligjvënësi kur ka parashikuar të drejtën për t’u ankuar kundër dekretit të Presidentit në gjykatë. Fakti që nuk ka një rregullim tjetër ligjor, mbas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nuk do interpretuar si mungesë rregullimi ligjor në disfavor të mbrojtjes në detyrë të prokurorëve.

Fakti që organi i prokurorisë nuk bën më pjesë në sistemin gjyqësor, nuk do të thotë që ai është lënë pa mbrojtje dhe pa akses në gjykatë për të kërkuar vendin e tij të punës kur ai mendon e vlerëson se i është marrë me pa të drejtë. Këtë e bën më bindës edhe fakti se organi i prokurorisë, sipas nenit 148/3 të Kushtetutës, në ushtrimin e kompetencave i nënshtrohet Kushtetutës dhe ligjeve.

Presidenti i Republikës, ndër të tjera është një figurë politike dhe fakti, që atij i është dhënë e drejta e lirit apo transferimit në detyrë të prokurorit, kërkon domosdoshmërisht, ashtu sikurse ka pranuar edhe ligjvënësi, që verifikimi i ushtrimit të të drejtave të tij, kur ka ankim, të bëhet nga gjykata, e cila sipas neneve 7 dhe 145/1 të Kushtetutes ushtron funksionin e saj në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet dhe në mënyrë të pavarur nga pushtetet e tjera.

Për të gjitha këto, pakica ka mendimin se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është i drejtë, i mbështetur në ligj e për këtë shkak ai duhej të lihej në fuqi.

Valentina Kondili, Natasha Sheshi, Kristaq Ngjela, Artan Hoxha, Ylvi Myrtja

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

|                                                                                                            |                                                                                                                                                   |                                                                                                                  |                                                                                                  |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Kodi Penal</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Mars, 2002               | <b>Kodi i<br/>Procedurës Penale</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Shtator, 2002                                 | <b>Kodi i<br/>Procedurës Civile</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Korrik, 2002 | <b>Kodi Rrugor</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Qershor, 2002 |
| <b>Kodi Penal<br/>Ushtarak</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 | <b>Përmbledhëse<br/>legjislacioni<br/>në fushën<br/>e Përmbarimit</b><br><br><i>Botim i Qendrës<br/>së Publikimeve Zyrtare</i><br><br>Tetor, 2002 |                                                                                                                  |                                                                                                  |

U dorëzua për shtyp më 4.4.2003

Doli nga shtypi më 5.4.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë